



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT-LIGJ¹

Nr. ____/2026

PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të Neneve 78, 81, pika 2, shkronja “a” dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi

1. Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë është person juridik publik që mund të nxjerrë akte normative, të lidhë kontrata dhe të marrë pjesë në procedura gjyqësore.

¹ Ky projektligj është përafuar me:

- Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)) CELEX Nr. 12012M/TXT;
- Protokollin Nr. 4 mbi Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane (Protokolli Nr. 4) CELEX Nr. 12016E/PRO/04

Neni 2

Selia dhe simbolet

1. Selia qendrore e Bankës së Shqipërisë ndodhet në Tiranë.
2. Banka e Shqipërisë mund të hapë filiale, degë, zyra përfaqësimi dhe ambiente pune brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Stema e Bankës së Shqipërisë është Stema e Republikës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë mund të përdorë, përveç stemës, edhe një logo të personalizuar.
5. Vula e Bankës së Shqipërisë është rrethore, me stemën e Republikës së Shqipërisë në qendër dhe me emërtimin “Banka e Shqipërisë”, në përputhje me legjislacionin përkatës.
6. Banka e Shqipërisë vendos lidhur me përdorimin e vulave të tjera ndihmëse.

Neni 3

Kapitali

1. Kapitali i Bankës së Shqipërisë përbëhet nga kapitali i nënshkruar dhe llogaritë rezervë, të përshkruara në Nenin 51.
2. Kapitali i nënshkruar i Bankës së Shqipërisë është i paguar plotësisht dhe është vlerën 6 (gjashtë) miliardë lekë.
3. Kapitali i nënshkruar është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar, nuk është i transferueshëm, nuk mund të përdoret si garanci dhe nuk i nënshtrohet sekuestrimit.
4. Kapitali i nënshkruar mund të rritet nga Qeveria, me propozim të Bankës së Shqipërisë, ose në përputhje me Nenin 51.
5. Kapitali i nënshkruar nuk mund të zvogëlohet.

Neni 4

Pavarësia

1. Banka e Shqipërisë është e pavarur në përmbushjen e objektivave dhe kryerjen e detyrave të parashikuara në këtë ligj. Banka e Shqipërisë dhe anëtarët e organeve të saj vendimmarrëse, si edhe stafi, nuk duhet të kërkojnë dhe as nuk duhet të marrin udhëzime nga institucionet shtetërore ose nga ndonjë person tjetër fizik ose juridik.
2. Institucionet shtetërore dhe çdo person tjetër fizik ose juridik duhet të respektojnë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë dhe nuk duhet të ndikojnë te anëtarët e organeve të saj vendimmarrëse dhe stafi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

KAPITULLI II

OBJEKTIVAT, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME

Neni 5

Objektivat

1. Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve.
2. Pa rënë ndesh me objektivin kryesor, Banka e Shqipërisë kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar.
3. Pa rënë ndesh me objektivin kryesor lidhur me stabilitetin e çmimeve dhe atë dytësor lidhur me stabilitetin financiar, Banka e Shqipërisë mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
4. Banka e Shqipërisë vepron në përputhje me parimet e një ekonomie të tregut të hapur, konkurrencës së lirë dhe shpërndarjes efikase të burimeve.

Neni 6

Detyrat

Me qëllim përmbushjen e objektivave të saj, Banka e Shqipërisë kryen detyrat e mëposhtme:

- a) përcakton dhe zbaton politikën monetare;
- b) përcakton dhe zbaton regjimin dhe politikën e këmbimit valutor;
- c) mban dhe menaxhon rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë;
- d) emeton dhe administron monedhën kombëtare;
- e) përcakton dhe zbaton politikën makroprudenciale;
- f) nxit dhe mbikëqyr funksionimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit të pagesave;
- g) rregullon, licencon dhe mbikëqyr institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- h) ushtron funksionet e autoritetit për rimëkëmbje dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- i) ofron linjë likuiditeti, në përputhje me Nenin 13;
- j) mbledh, përpunon dhe publikon statistika monetare, financiare dhe të sektorit të jashtëm;
- k) kryen çdo detyrë tjetër, në përputhje me këtë ligj dhe ligje të tjera, dhe që nuk bien në kundërshtim me objektivat e Bankës së Shqipërisë, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 7

Kompetencat e përgjithshme

Me qëllim përmbushjen e objektivave dhe kryerjen e detyrave të saj, Banka e Shqipërisë, përveç kompetencave të tjera të përcaktuara në këtë ligj, ka dhe kompetencat e mëposhtme:

- a) nxjerr akte normative;
- b) blen, shet, administron dhe disponon pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- c) hap llogari në monedhë dhe tituj për institucionet e kreditit, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, operatorët e sistemeve të pagesave, depozitarët qendrorë të titujve, kundërpalët qendrore, subjektet publike me profil financiar që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, bankat qendrore të huaja, organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë institucionet dhe organizatat financiare ndërkombëtare, si dhe qeveritë e huaja;
- d) pranon llogaritë e përmendura në nënpikën (c) të këtij neni dhe lloje të tjera aktivesh, duke përfshirë tituj të dematerializuar, si kolateral;
- e) hap dhe mban llogari në monedhë dhe tituj në regjistrat kontabël të institucioneve të huaja financiare dhe bankave, bankave qendrore, institucioneve depozituese dhe organizatave ndërkombëtare;
- f) lidh kontrata dhe marrëveshje;
- g) bashkëpunon, shkëmben informacione, koordinon aktivitete, merr pjesë dhe angazhohet në çdo formë tjetër bashkëpunimi me autoritetet vendase dhe të huaja, siç janë autoritetet rregullatore, mbikëqyrëse ose monetare, si dhe me institucionet e organizatave financiare ndërkombëtare publike, të cilat i nënshtrohen detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit sipas Nenit 68;
- h) çdo kompetencë tjetër të nevojshme për të përmbushur objektivat e saj dhe për të kryer detyrat e saj në përputhje me këtë ligj.

KAPITULLI III

SISTEMET E PAGESAVE

Neni 8

Sistemi i Pagesave

Me qëllim kryerjen e detyrave të saj në fushën e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë:

- a) mund të zotërojë, operojë ose marrë pjesë në sisteme pagesash, klerimi dhe shlyerjeje titujsh;
- b) mund të ofrojë lehtësira, përfshirë kredi brenda ditës, për pjesëmarrësit e sistemeve të përmendura në shkronjën “a” të këtij neni, në përputhje me veprimtaritë për të cilat këta

- pjesëmarrës janë licencuar ose autorizuar, sipas legjislacionit përkatës;
- c) rregullon dhe mbikëqyr sistemet e pagesave, si dhe shërbimet dhe instrumentet e pagesave në masën që ato janë pjesë përbërëse të këtyre sistemeve, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - d) bashkëpunon me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e infrastrukturave të tregut financiar me rëndësi sistematike.

KAPITULLI IV

OPERACIONET MONETARE DHE TË TJERA

Neni 9

Hapja e llogarive

1. Banka e Shqipërisë mund të hapë llogari dhe të pranojë si kolateral aktive, përfshirë titujt e dematerializuar.
2. Llogaritë mund të hapen për:
 - a) institucione krediti, institucione pagesash, institucione të parasë elektronike, operatorë të sistemeve të pagesave, depozitarët qendrorë të titujve, kundërpalë qendrore dhe subjekte publike me profil financiar që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë;
 - b) banka qendrore, organizata ndërkombëtare, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe qeveri të huaja.
3. Banka e Shqipërisë mund të hapë llogari për punonjësit e institucionit.
4. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet për hapjen, funksionimin dhe mbylljen e llogarive në librat e saj, duke përfshirë kërkesat dhe llojet e aktiveve të pranueshme si kolateral.
5. Banka e Shqipërisë mund të hapë dhe të mbajë llogari në njësi monetare dhe tituj në regjistrat kontabël të institucioneve të huaja financiare dhe bankave, bankave qendrore, institucioneve depozituese dhe organizatave ndërkombëtare.

Neni 10

Operacionet në tregjet financiare

1. Banka e Shqipërisë mund të operojë në tregjet financiare, duke:
 - a) blerë dhe shitur tituj dhe instrumente të tjera financiare të tregtueshëm, në mënyrë përfundimtare (me dorëzim të menjëhershëm ose në të ardhmen) ose nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes;
 - b) blerë dhe shitur monedha të huaja dhe metale të çmuara;
 - c) pranuar depozita;

- d) emetuar tituj;
 - e) kryer operacione të kreditit kundrejt kolateralit të mjaftueshëm për zbatimin e politikave të saj.
2. Këshilli përcakton llojet e instrumenteve dhe kolateralit që do të përdoren për operacionet sipas nënpikës 1 të këtij neni, kundër palët në këto operacione dhe kushtet sipas të cilave Banka e Shqipërisë është e gatshme të hyjë në transaksione të tilla.

Neni 11

Rezerva e detyrueshme

1. Banka e Shqipërisë mund t'u kërkojë institucioneve të kreditit që ajo licencon dhe mbikëqyr që të mbajnë rezerva të detyrueshme në llogaritë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë, në monedhë vendase dhe/ose të huaj.
2. Banka e Shqipërisë mund të paguajë interesa mbi rezervat e detyruara.
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit për të mbajtur rezervën e detyruar, Banka e Shqipërisë vendos masë administrative, e cila është në proporcion me shkallën e mos përmbushjes dhe nuk mund të kalojë trefishin e normës më të lartë të interesit të miratuar prej saj.
4. Këshilli përcakton nivelin e rezervës së detyruar, kategoritë e detyrimeve që i nënshtrohen kësaj kërkesë, koeficientet e llogaritjes, normat e interesit të zbatueshme dhe nivelin e masës administrative.

Neni 12

Instrumente të tjera të politikës monetare

Këshilli, me shumicë votash prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të tij, mund të vendosë që të përdorë metoda të tjera operacionale të politikës monetare, siç e konsideron të përshtatshme, në përputhje me objektivat e Bankës së Shqipërisë.

Neni 13

Ofrimi i linjës së likuiditetit

1. Kur rrezikohet stabiliteti financiar, Këshilli mund t'i japë kredi një institucioni krediti të licencuar dhe të mbikëqyrur prej tij, i cili përballët me një mungesë të përkohshme likuiditeti, të shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme, me kusht që institucioni të vlerësohet se ka aftësi paguese dhe të ofrojë kolateral të mjaftueshëm.
2. Këshilli përcakton kriteret për vlerësimin e aftësisë paguese dhe masat korrigjuese që subjekti, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të zbatojë gjatë periudhës së kredisë, llojet e kolateralit të pranueshëm, duke përfshirë parimet e vlerësimit dhe zbutjes së rrezikut, afatin e kredisë ose

likuiditetit të ofruar, si dhe normën e pagueshme të interesit, e cila duhet të jetë normë interesi penalizuese.

3. Kredia jepet në këste dhe i nënshtrohet rishikimeve periodike. Çdo zgjatje e afatit ose rritje e shumës kërkon rivlerësim të kushteve dhe marrjen e një vendimi të veçantë. Në çdo rast, afati i kredisë nuk mund të jetë më i gjatë se dymbëdhjetë muaj.
4. Kur stabiliteti financiar është në rrezik, Banka e Shqipërisë mund të lidhë marrëveshje financimi afatshkurtra me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, kundrejt garancisë me tituj të emetuar nga qeveria dhe në pronësi të kësaj agjencie, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe pa rënë ndesh me ndalimet ligjore për financimin monetar.
5. Këshilli vendos për dhënien, vazhdimin, ndryshimin ose ndërprerjen e mbështetjes për kredi dhe likuiditet sipas këtij neni.

KAPITULLI V

KËMBIMI VALUTOR

Neni 14

Operacionet dhe këmbimet valutore

Në përputhje me objektivin kryesor dhe me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, Banka e Shqipërisë:

- a) llogarit dhe publikon kursin zyrtar të këmbimit për konvertimin e monedhave të huaja në Lek;
- b) kryen pagesa me vendet e tjera, në përputhje me funksionet e saj si bankë qendrore;
- c) kryen operacione të këmbimit valutor, në përputhje me këtë ligj.

Neni 15

Rezerva valutore

1. Banka e Shqipërisë mban dhe menaxhon rezervën valutore me qëllim zbatimin dhe mbështetjen e politikës monetare, politikës së kursit të këmbimit dhe stabilitetit financiar të vendit.
2. Banka e Shqipërisë administron rezervën valutore në përputhje me parimet e likuiditetit dhe sigurisë së investimeve. Në procesin e menaxhimit, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, mund të merren parasysh edhe parime të tjera për sa kohë ato nuk dëmtojnë likuiditetin dhe sigurinë e rezervës valutore.

KAPITULLI VI

NJËSIA MONETARE DHE KURSI LIGJOR

Neni 16

Njësia monetare

1. Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është “Lek-u”.
2. Kartëmonedhat, monedhat metalike dhe monedha digjitale “Lek”, të emetuara nga Banka e Shqipërisë, kanë kurs ligjor në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pranohen në vlerën e tyre nominale për shlyerjen e të gjitha detyrimeve monetare publike dhe private.

Neni 17

E drejta ekskluzive e emetimit

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të emetuar kartëmonedha, monedha metalike dhe monedha digjitale “Lek”.
2. Banka e Shqipërisë përcakton prerjet, tematikat, pamjen, formën, dimensionet, peshën, përbërjen, materialet e shtypjes, elementet e sigurisë dhe çdo karakteristikë tjetër teknike të kartëmonedhave dhe monedhave.
3. Vlera totale e kartëmonedhave, monedhave metalike dhe monedhës digjitale “Lek”, në qarkullim, regjistrohet si detyrim në pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 18

Emetimi, prodhimi dhe qarkullimi i monedhës

1. Banka e Shqipërisë harton programe emetimi, përcakton sasinë e nevojshme të kartëmonedhave, monedhave metalike dhe monedhës digjitale “Lek”, organizon prodhimin dhe ruajtjen e tyre në kushte të sigurta dhe siguron furnizimin e rregullt të ekonomisë, në përputhje me kërkesën për monedhë në qarkullim.
2. Këshilli miraton rregullat për prodhimin, hedhjen në qarkullim, rihedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave, monedhave metalike dhe monedhës digjitale “Lek”.

Neni 19

Përfundimi i kursit ligjor

1. Banka e Shqipërisë vendos për përfundimin e statusit të kursit ligjor dhe tërheqjen nga qarkullimi të çdo kartëmonedhe, monedhe metalike ose monedhe digjitale “Lek” të emetuar nga Banka e Shqipërisë, kundrejt shkëmbimit të tyre me vlerë nominale.
2. Vendimi përcakton datën e përfundimit të statusit të kursit ligjor, si dhe periudhën e shkëmbimit, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit nga data e përfundimit të statusit të kursit ligjor.
3. Pas skadimit të periudhës së mësipërme, vlera e kartëmonedhave, monedhave metalike, dhe monedhës digjitale “Lek” të cilat nuk paraqiten për shkëmbim, zbritet nga vlera e monedhës në qarkullim dhe njihet si e ardhur e jashtëzakonshme e Bankës së Shqipërisë.
4. Kartëmonedhat, monedhat metalike dhe monedha digjitale “Lek”, pa kurs ligjor, asgjësohen dhe zëvendësohen me emetime të tjera me kurs ligjor.

Neni 20

Emetimi numizmatike

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të emetuar kartëmonedha dhe monedha numizmatike ose përkujtime.
2. Këshilli përcakton prerjet, tematikat, pamjen, dimensionet, peshën, përbërjen dhe karakteristikat e tjera të këtyre emetimeve, si dhe rregullat për emetimin, shpërndarjen, çmimet dhe shitjen.
3. Kartëmonedhat dhe monedhat numizmatike ose përkujtime, pavarësisht nëse kanë apo jo kurs ligjor, mund të shiten me një çmim të ndryshëm nga vlera e tyre nominale ose kostoja e prodhimit.

Neni 21

Kartëmonedha dhe monedha të papërshtatshme ose të dëmtuara

1. Banka e Shqipërisë tërheq nga qarkullimi, asgjëson dhe zëvendëson në vlerë nominale kartëmonedhat dhe monedhat metalike që janë të papërshtatshme për qarkullim ose të dëmtuara.
2. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 1, Banka e Shqipërisë mund të refuzojë të shkëmbejë kartëmonedhat dhe monedhat metalike që u mungon më shumë se 50% e sipërfaqes së tyre ose janë dëmtuar qëllimisht.
3. Këshilli përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin, tërheqjen nga qarkullimi, shkëmbimin dhe asgjësimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të papërshtatshme ose të dëmtuara.

Neni 22

Materialet e shtypjes dhe origjinimit

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të administrojë dhe, sipas nevojës, të asgjesojë materialet bazë të përdorura për shtypjen dhe origjinimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike.

Neni 23

Mbrojtja nga falsifikimi

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për analizën dhe ekzaminimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara, shqiptare ose të huaja, me qëllim përcaktimin e autenticitetit, falsifikimit ose ndryshimit të paligjshëm të tyre.
2. Subjektet që përpunojnë kartëmonedha dhe monedha metalike veçojnë çdo njësi të dyshuar dhe ia dorëzojnë atë menjëherë Bankës së Shqipërisë për ekzaminim.
3. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara ose të ndryshuara në mënyrë të paligjshme mbahen pa kompensim. Përveç rasteve kur kërkohet nga organet përkatëse të zbatimit të ligjit, ato mbahen për qëllime mbrojtjeje nga falsifikimi ose shkatërrohen në mënyrë të sigurt.
4. Banka e Shqipërisë mbledh, përpunon dhe administron të dhëna teknike mbi kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara dhe përcakton rregullat për tërheqjen, trajtimin dhe asgjësimin e tyre.
5. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet kompetente kombëtare dhe të huaja me qëllim mbrojtjen e monedhës nga falsifikimi.

Neni 24

Riprodhimi i kartëmonedhave dhe monedhave

1. Ndalohet riprodhimi, ofrimi, shitja ose shpërndarja e çdo imazhi të shtypur ose digjital ose objekti që i ngjan kartëmonedhave ose monedhave metalike, në mënyrë të tillë që mund ta bëjë publikun të besojë gabimisht se ato janë emetuar nga Banka e Shqipërisë ose nga një bankë qendrore e huaj.
2. Riprodhimi i plotë ose i pjesshëm i kartëmonedhave dhe monedhave për qëllime reklamimi, edukative, artistike ose qëllime të tjera lejohet vetëm në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga Këshilli.

KAPITULLI VII

STABILITETI FINANCIAR

Neni 25

Detyrat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë si autoriteti përgjegjës për rregullimin, licencimin dhe mbikëqyrjen e kujdeshme të institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare, në përputhje me legjislacionin përkatës, ka kompetencat e mëposhtme:

- a) të vendosë masa administrative;
- b) të kryejë inspektime në terren, duke shqyrtuar llogaritë, librat, dokumentet dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm nga stafi dhe persona të tjerë të autorizuar dhe të kualifikuar;
- c) të kërkojë nga këto subjekte, të cilat kanë detyrimin për të paraqitur, çdo informacion dhe dokumentacion përkatës që lidhet me veprimtarinë e subjekteve, gjendjen financiare dhe administrimin e rrezikut;
- d) të publikojë informacione dhe të dhëna të marra sipas këtij neni vetëm në formë të përmbledhur, për kategoritë e institucioneve të përcaktuara sipas natyrës së aktivitetit të tyre, ose në përputhje me Nenin 68 të këtij ligji;
- e) të zbatojë masat makroprudenciale për kufizimin e rrezikut sistemik, në përputhje me Nenin 26.

Neni 26

Masat makroprudenciale

1. Për të mbrojtur stabilitetin e sistemit financiar, Banka e Shqipërisë vlerëson zhvillimet e rrezikut sistemik dhe ndërmerr masa makroprudenciale për ta kufizuar atë.
2. Masat makroprudenciale janë kryesisht të natyrës prudenciale që synojnë të rrisin qëndrueshmërinë e sistemit financiar ndaj goditjeve të përgjithshme, të parandalojnë grumbullimin e dobësive sistemike me kalimin e kohës dhe të kontrollojnë dobësitë strukturore brenda sistemit financiar.
3. Për të vlerësuar rrezikun sistemik dhe për të zbatuar masa makroprudenciale, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritete të tjera vendase dhe të huaja.

KAPITULLI VIII

SISTEMI RAPORTUES DHE STATISTIKAT

Neni 27

Sistemi raportues

1. Banka e Shqipërisë siguron raportimin statistikor, i cili përfshin mbledhjen e të dhënave për qëllime statistikore, përpunimin dhe prodhimin e informacionit statistikor, si dhe hartimin, administrimin dhe publikimin e statistikave monetare, financiare dhe të sektorit të jashtëm.
2. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë dhe të mbledhë, pa pagesë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për statistikën zyrtare, informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në formën e raporteve statistikore nga subjektet raportuese, të cilat përfshijnë:
 - a) subjektet e mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë;
 - b) subjektet e tjera, informacioni i të cilave është i nevojshëm për hartimin e sistemit të llogarive kombëtare të Republikës së Shqipërisë;
 - c) personat fizikë dhe juridikë që disponojnë të dhëna të nevojshme për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe borxhit të jashtëm;
 - d) çdo person tjetër fizik ose juridik që disponon të dhëna të nevojshme për përmbushjen e detyrave statistikore të Bankës së Shqipërisë.
3. Banka e Shqipërisë mund të përdorë raportet e mbledhura sipas këtij neni për përmbushjen e detyrave të saj statistikore.
4. Banka e Shqipërisë mund të marrë, pa pagesë, të dhëna dhe informacion nga regjistrat administrativë të autoriteteve dhe institucioneve publike, kur këto janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të saj statistikore dhe që transmetohen në përputhje me legjislacionin për konfidencialitetin e të dhënave.
5. Subjektet raportuese përgatisin dhe paraqesin raportet statistikore pranë Bankës së Shqipërisë në formën, përmbajtjen, afatet dhe mënyrën e përcaktuar në aktet normative të Bankës së Shqipërisë.
6. Kur raportet statistikore të paraqitura nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara ose kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme lidhur me saktësinë, plotësinë ose cilësinë e të dhënave të raportuara, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë korrigjimin, sqarimin ose plotësimin e tyre.

Neni 28

Statistikat

1. Banka e Shqipërisë përpilon, bashkërendon, administron dhe publikon statistikën monetare, financiare, statistikën e bilancit të pagesave, statistikën e llogarive financiare dhe statistika të tjera

që lidhen me përmbushjen e detyrave të saj statistikore.

2. Për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Institutin e Statistikave dhe autoritetet e tjera publike, në përputhje me marrëveshjet përkatëse dhe legjislacionin përkatës.
3. Banka e Shqipërisë shkëmben informacion statistikor me institucionet financiare, dhe organizatat ndërkombëtare në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi dhe marrëveshjet ndërkombëtare
4. Banka e Shqipërisë siguron mbrojtjen e informacionit statistikor konfidencial në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare dhe nenin 68 të këtij ligji, si dhe garanton përdorimin e tij vetëm për qëllime statistikore.

Neni 29

Ofrimi i të dhënave dhe informacionit statistikor

Personat fizikë dhe juridikë që janë subjekt i kërkesave për raportim statistikor janë të detyruar të paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë informacionin e kërkuar, në përputhje me aktet normative të miratuara për këtë qëllim.

Neni 30

Shpërndarja e statistikave dhe informacionit statistikor

1. Banka e Shqipërisë publikon statistika dhe informacion statistikor, në përputhje me rregullat për konfidencialitetin, duke garantuar transparencën dhe njohjen e publikut me to.
2. Informacioni statistikor që mundëson identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të subjekteve raportuese konsiderohet informacion statistikor konfidencial dhe nuk publikohet.
3. Banka e Shqipërisë publikon metodologjitë statistikore, konceptet dhe metadatat, me qëllim garantimin e krahasueshmërisë së statistikave, dhe verifikimit të jashtëm të tyre.

KAPITULLI IX

MARRËDHËNIET ME QEVERINË DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE

Neni 31

Banka e Shqipërisë si agjent fiskal

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të Qeverisë, mund të kryejë veprime që lidhen me emetimin e titujve shtetërore, duke përfshirë regjistrimin e tyre, zhvillimin e ankandeve, shlyerjen e principalit, interesit dhe shpenzimeve të tjera që lidhen me titujt si dhe veprime të tjera ndihmëse,

në përputhje me marrëveshjen përkatëse të lidhur për këtë qëllim me ministrin përgjegjës për financat dhe duke respektuar, në çdo rast, ndalimin e financimit monetar.

Neni 32

Banka e Shqipërisë si bankieri i Qeverisë

1. Banka e Shqipërisë mund të hapë dhe të mbajë llogari për Qeverinë dhe institucionet financiare shtetërore.
2. Banka e Shqipërisë kryen veprime pagesash nga llogaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni vetëm në kufijtë e mjeteve monetare të disponueshme në këto llogari dhe mbi bazën e kërkesave të autorizuara.
3. Banka e Shqipërisë mund të paguajë interes për fondet monetare të mbajtura në këto llogari, me norma interesi që nuk tejkalojnë normat e tregut për instrumente financiare të krahasueshme.
4. Banka e Shqipërisë përcakton komisionet për shërbimet e ofruara sipas këtij neni.
5. Niveli i normave të interesit dhe i komisioneve përcaktohet me marrëveshje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe ministrit përgjegjës për financat.

Neni 33

Bashkëpunimi me Qeverinë dhe subjektet e tjera publike

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Qeverinë dhe institucionet e tjera publike për çështje me interes të përbashkët, brenda objektivave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë ligj, pa cenuar pavarësinë dhe autonominë e saj.
2. Banka e Shqipërisë dhe ministria përgjegjës për financat shkëmbejnë, në mënyrë të ndërsjellë, informacion mbi çështje që lidhen me politikën monetare, politikën fiskale, sistemin financiar dhe zhvillimet e tjera makroekonomike.
3. Banka e Shqipërisë mund të këshillojë Qeverinë për çështje që lidhen me objektivat dhe detyrat e saj të përcaktuara në këtë ligj.
4. Banka e Shqipërisë konsultohet për çdo projektligj ose projektakt normativ që lidhet me objektivat dhe detyrat e saj, përpara miratimit të tij. Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë i bashkëlidhet projektligjit që i paraqitet Kuvendit.

Neni 34

Ndalimi i financimit monetar

1. Banka e Shqipërisë nuk lejohet të japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, asnjë kredi ose lehtësi krediti, përfshirë kredi kufi (*overdrafts*), linja kredie ose çdo formë tjetër financimi, për Qeverinë, institucionet shtetërore qendrore ose vendore, apo subjekte të tjera publike.

2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për:
 - a) institucionet e kreditit në pronësi shtetërore, të cilat trajtohen në mënyrë të njëjtë me institucionet private të kreditit, në kuadër të këtij ligji;
 - b) detyrimet që rrjedhin nga kuotat e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në organizatat financiare ndërkombëtare. Transaksionet përkatëse regjistrohen në bilancin e Bankës së Shqipërisë dhe nuk konsiderohen financim monetar.
3. Banka e Shqipërisë nuk mund të blejë instrumente borxhi të emetuara nga subjektet e përmendura në pikën 1 në tregun primar, por mund t'i blejë ato vetëm në tregun sekondar.

Neni 35

Blerja në tregun primar

Në përjashtim nga neni 34, pika 3, Banka e Shqipërisë mund të blejë tituj të qeverisë në tregun primar vetëm për qëllime të administrimit të strukturës së bilancit të saj dhe vetëm për riinvestimin e fondeve që rrjedhin nga maturimi i titujve ekzistues të qeverisë të mbajtur prej saj, me kusht që titujt e blerë:

- a) të kenë maturitet fillestar jo më të gjatë se titujt që maturohen;
- b) të jenë njoftuar paraprakisht;
- c) të blihen me çmim tregu.

KAPITULLI X

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 36

Organet drejtuese

1. Banka e Shqipërisë drejtohet nga Këshilli dhe nga administratorët, që janë guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët.
2. Këshilli përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë:
 - a) guvernatori, i cili është Kryetar i Këshillit;
 - b) zëvendësguvernatori i parë i Bankës së Shqipërisë, i cili është Zëvendëskryetar i Këshillit;
 - c) zëvendësguvernatori i dytë i Bankës së Shqipërisë; dhe
 - d) gjashtë anëtarë.

Kompetencat e Këshillit

1. Këshilli është përgjegjës për hartimin e politikave të Bankës së Shqipërisë, si dhe për mbikëqyrjen e: (i) zbatimit të këtyre politikave dhe (ii) administrimit të veprimtarisë të Bankës së Shqipërisë.
2. Për këtë qëllim, Këshilli ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) miraton politikën monetare dhe përcakton instrumentet për zbatimin e saj;
 - b) përcakton politikën për rezervën e detyrueshme;
 - c) përcakton regjimin dhe politikën e kursit të këmbimit valutor;
 - d) përcakton politikat për rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare;
 - e) përcakton politikat për stabilitetin financiar, brenda fushës së detyrave të ngarkuara Bankës së Shqipërisë me këtë ligj;
 - f) miraton politikën e administrimit të rezervës valutore;
 - g) përcakton financimin në rrethana të jashtëzakonshme;
 - h) vendos për prerjet, konfigurimet, emetimin dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike, si dhe rregullat për qarkullimin e tyre.
 - i) miraton strategjinë e politikës makroprudenciale, aktet rregullatore për zbatimin e kësaj politike dhe vendos për aktivizimin e instrumenteve makroprudenciale;
 - j) miraton, refuzon dhe revokon licencat dhe miratimet paraprake për institucionet e kreditit, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - k) miraton vendimet për vendosjen e një banke në proces ndërhyrjeje të jashtëzakonshme, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - l) miraton rregullat e funksionimit dhe të mbikëqyrjes të sistemit të pagesave;
 - m) miraton strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë, si dhe hapjen ose mbylljen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit;
 - n) miraton emërimin dhe shkarkimin, me propozim të Guvernatorit, të Drejtorit të Departamentit të Auditimit, si dhe të drejtuesve të tjerë të departamenteve të Bankës së Shqipërisë;
 - o) miraton rezultatin financiar vjetor, pasqyrat financiare të audituara dhe vendos për shpërndarjen e fitimit, krijimin dhe përdorimin e rezervave të Bankës së Shqipërisë;
 - p) miraton raportin vjetor dhe raportet e tjera që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit;
 - q) emëron auditorin e jashtëm për auditimin e llogarive, regjistrave dhe pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë, si dhe të pasqyrave financiare të Fondit të Pensionit.
 - r) miraton buxhetin vjetor dhe afatmesëm të Bankës së Shqipërisë;
 - s) miraton kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut, vazhdimësinë e veprimtarisë, planifikimin për situata/ngjarje të paparashikuara, kuadrin rregullator prokurimet, si dhe çdo politikë tjetër të nevojshme në funksion të ushtrimit të funksionit të tij mbikëqyrës;
 - t) krijon Komitetin e Auditimit, si dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tij;
 - u) miraton rregullat e funksionimit dhe detyrat e Komitetit të Politikës Monetare dhe të Komitetit të Stabilitetit Financiar;

- v) përcakton politikën e trajtimit financiar për anëtarët e Këshillit, Guvernatorin, Zëvendësguvernatorët, si dhe stafin e Bankës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 47;
 - w) vendos krijimin e fondit të pensioneve dhe miraton politikat dhe rregullat për administrimin dhe investimin e tij, duke siguruar mekanizma të qëndrueshëm stabilizues që synojnë ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe vijueshmërisë së performancës në nivele të përshtatshme;
 - x) përcakton politikat për marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Banka e Shqipërisë;
 - y) miraton aktet normative të brendshme të Bankës së Shqipërisë që lidhen me funksionet e saj të politikëbërjes dhe mbikëqyrjes, si dhe aktet e tjera me zbatim të përgjithshëm të autorizuara me ligj;
 - z) miraton rregulloren e brendshme për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Këshillit;
 - aa) ushtron çdo kompetencë tjetër të nevojshme për përmbushjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë, që nuk kanë karakter ekzekutiv.
3. Përveç kompetencave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Këshilli ushtron çdo kompetencë tjetër të përcaktuar në këtë ligj.
 4. Vendimet e Këshillit sipas pikës 2, shkronja “c” të këtij neni miratohen me shumicë prej dy të tretave të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Neni 38

Komiteti i Politikës Monetare

1. Pranë Bankës së Shqipërisë ngrihet Komiteti i Politikës Monetare, me funksion këshillimor ndaj Këshillit në lidhje me hartimin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, me qëllim arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.
2. Ky komitet ushtron gjithashtu funksion këshillimor ndaj Guvernatorit për çështjet që lidhen me zbatimin e politikave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Komiteti i Politikës Monetare përbëhet nga Guvernatori, Zëvendësguvernatorët, drejtuesit e departamenteve përgjegjëse për politikën monetare, kërkimeve, operacionet e tregut, si dhe drejtuesit e departamenteve të tjera, përfshirja e të cilëve vlerësohet e nevojshme.

Neni 39

Komiteti për Stabilitetin Financiar

1. Pranë Bankës së Shqipërisë ngrihet Komiteti i Stabilitetit Financiar, me funksion këshillimor ndaj Këshillit për politikat në lidhje me stabilitetin financiar.
2. Ky komitet ushtron gjithashtu funksion këshillimor ndaj Guvernatorit për çështjet që lidhen me zbatimin e politikave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Komiteti i Stabilitetit Financiar përbëhet nga Guvernatori, Zëvendësguvernatorët, drejtuesit e departamenteve përgjegjëse për stabilitetin financiar, kërkimeve, si dhe drejtuesit e

departamenteve të tjera, përfshirja e të cilëve vlerësohet e nevojshme.

Neni 40

Guvernatori

1. Guvernatori është organi ekzekutiv drejtues dhe përfaqësuesi ligjor i Bankës së Shqipërisë. Ai është përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj, si dhe për zbatimin e politikave dhe vendimeve të Këshillit.
2. Guvernatori ka kompetencë të lidhë kontrata dhe marrëveshje në emër të Bankës së Shqipërisë.
3. Guvernatori emëron, pezullon dhe shkarkon personelin e Bankës së Shqipërisë, në përputhje me rregulloret e miratuara nga Këshilli.
4. Guvernatori nxjerr vendime, udhëzime për drejtimin e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë, si dhe për zbatimin e politikave dhe vendimeve të Këshillit.
5. Guvernatori ushtron kompetencat me natyrë ekzekutive të nevojshme për arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë.
6. Guvernatori mund të krijojë komitete për ta asistuar atë në ushtrimin e kompetencave të tij ekzekutive, si dhe të përcaktojë përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tyre.
7. Guvernatori mund të delegojë një pjesë të funksioneve të tij te Zëvendësguvernatorët, me kusht që njëri Zëvendësguvernator të jetë përgjegjës për politikën monetare, ndërsa Zëvendësguvernatori tjetër të jetë përgjegjës për stabilitetin financiar. Guvernatori mund të delegojë gjithashtu një pjesë të funksioneve të tij te personeli i Bankës së Shqipërisë.
8. Në rast se Guvernatori mungon ose është i pamundur të ushtrojë funksionet e tij, ai zëvendësohet nga Zëvendësguvernatori i Parë për kohëzgjatjen e mungesës ose të pamundësisë për të ushtruar funksionet. Në rast se si Guvernatori, ashtu edhe Zëvendësguvernatori i Parë mungojnë ose janë të pamundur të ushtrojnë funksionet e tyre, Guvernatori zëvendësohet nga Zëvendësguvernatori i Dytë për kohëzgjatjen e mungesës ose të pamundësisë për të ushtruar funksionet. Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, nënshkrimi i aktit ose i vendimit nga Zëvendësguvernatori përkatës përbën provë përfundimtare të ekzistencës së rrethanave që justifikojnë zëvendësimin e Guvernatorit.

Neni 41

Emërimi i anëtarëve të Këshillit

1. Emërimi i anëtarëve të Këshillit kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe përbërja e Këshillit duhet të pasqyrojë fushat e ndryshme të ekspertizës, përfshirë ekonominë, financën, bankat, administrimin e rrezikut, çështje juridike dhe auditim-in, të nevojshme për realizimin e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të Bankës së Shqipërisë.
2. Anëtarët e Këshillit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bazuar në sa vijon:
 - a) Guvernatori propozohet nga Presidenti i Republikës, i cili propozon një anëtar të Këshillit për postin e Guvernatorit. Nëse Presidenti zgjedh të propozojë një kandidat që nuk është anëtar i Këshillit, propozimi i paraqitur Kuvendit përbën njëkohësisht propozim për emërimin e tij si

anëtar i Këshillit dhe për funksionin e Guvernatorit. Nëse Kuvendi miraton propozimin e Presidentit për një kandidat që është anëtar i Këshillit, Guvernatori ushtron funksionin për një mandat të plotë shtatëvjeçar, duke filluar nga data e miratimit të tij nga Kuvendi. E drejta për të propozuar kandidatin për plotësimin e vendit vakant, i takon institucionit që ka propozuar fillimisht anëtarin;

- b) katër anëtarë propozohen nga Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, në të cilin përfshihen edhe dy ekspertë të jashtëm me reputacion të lartë në fushat e financës, ekonomisë dhe bankave.
 - c) tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave.
 - d) një anëtar propozohet nga Këshilli i Bankës së Shqipërisë.
 - e) Guvernatori i propozon Këshillit Zëvendësguvernatorin e Parë dhe Zëvendësguvernatorin e Dytë, nga anëtarët e Këshillit. Pas miratimit të Zëvendësguvernatorëve, Këshilli njofton Kuvendin për vendimin e tij.
3. Mandati i çdo anëtari të Këshillit është shtatë vjet, me të drejtë riemërimi.

Neni 42

Kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve të Këshillit

Kandidatët për anëtarë të Këshillit duhet të jenë shtetas shqiptarë, të gëzojnë integritet të lartë moral dhe reputacion të spikatur profesional, si dhe të kenë arsim të lartë dhe mbi 10 vjet përvojë profesionale në pozicione drejtuese ose përvojë akademike në fushat e përcaktuara në nenin 41, pikën 1.

Neni 43

Papajtueshmëritë me funksionin e anëtarit të Këshillit

- 1. Nuk mund të emërohet anëtar i Këshillit ai personi i cili:
 - a) është dënuar nga një gjykatë kompetente për vepra penale që lidhen me shmangien e detyrimeve tatimore, mashtrimin ose vepra të tjera penale të lidhura me financat, ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për çdo vepër penale për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;
 - b) është ndaluar ose pezulluar nga ushtrimi i një funksioni publik ose profesioni, ose ndaj tij janë marrë masa të rënda disiplinore që cenojnë besueshmërinë ose integritetin e tij profesional.
- 2. Funksioni i anëtarit të Këshillit është i papajtueshëm me funksionin e:
 - a) titullarit të një funksioni publik, si Presidenti i Republikës së Shqipërisë, deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, anëtari i Këshillit të Ministrave; ose
 - b) punonjësit, administratorit ose aksionarit të subjekteve të licencuara dhe/ose të mbikëqyrura

nga Banka e Shqipërisë.

3. Funkzioni i Guvernatorit dhe i Zëvendësguvernatorit nuk mund të ushtrohet njëkohësisht me veprimtaritë e mëposhtme, përveç rastit kur përfaqësojnë Bankën e Shqipërisë në komitete ose organe që lidhen me përmbushjen e objektivit dhe ushtrimin e detyrave të saj:
 - a) çdo veprimtari tjetër profesionale, me ose pa shpërblim, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse ose shkencore;
 - b) çdo veprimtari tregtare që gjeneron të ardhura;
 - c) anëtarësinë në organet drejtuese të shoqërive tregtare; ose
 - d) ushtrimin e ndikimit influencues në shoqëri tregtare nëpërmjet pronësisë aktive ose kontrollit mbi to, përveç rasteve kur të drejtat e pronësisë ushtrohen nga një person i besuar, sipas parashikimeve të ligjit.
4. Anëtarët e Këshillit nuk mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike gjatë mandatit të tyre.
5. Anëtarët e Këshillit, të cilët nuk janë administratorë, mund të jenë të punësuar me kohë të plotë ose të ushtrojnë veprimtari profesionale ose ekonomike, për aq kohë sa kjo nuk përbën konflikt interesi sipas përcaktimeve të nenit 63.

Neni 44

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit dhe vazhdimësia në ushtrimin e detyrës

1. Mandati i anëtarit të Këshillit përfundon kur:
 - a) përfundon afati i mandatit;
 - b) anëtari jep dorëheqjen;
 - c) anëtari vdes; ose
 - d) anëtari mungon pa arsye dhe pa njoftuar Këshillin në dy mbledhje radhazi të Këshillit.
2. Këshilli njofton organet propozuese dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për krijimin e vendit vakant, të cilët ndërmarrin procedurat për plotësimin e tij brenda tre muajve.
3. Anëtarët vazhdojnë të ushtrojnë detyrën deri në emërimin e pasuesit të tyre, por jo më shumë se tre muaj pas përfundimit të mandatit.
4. Anëtari i emëruar për të plotësuar një vend vakant të krijuar si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit paraardhës, e ushtron funksionin për një mandat të plotë shtatëvjeçar.

Neni 45

Shkarkimi nga detyra

1. Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga Kuvendi përpara përfundimit të mandatit të tyre, me:
 - a) propozimin e Këshillit, në rast se konstatohet ndonjë nga kushtet e parashikuara në nenin 43 të këtij ligji; ose

- b) rekomandim të Këshillit, të miratuar me votim unanim të anëtarëve të tij, me të cilin konstatohet se anëtari nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet e tij sipas këtij ligji, bazuar në prova të përcaktuara sipas ligjit.
2. Në të dy rastet e parashikuara më sipër, Këshilli njofton anëtarin ndaj të cilit ka filluar procedura e shkarkimit, i cili ka të drejtë t'i paraqesë Gjykatës Kushtetuese një kërkesë për shqyrtimin e vlefshmërisë së propozimit ose rekomandimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Paraqitja e kërkesës pezullon çdo procedurë shkarkimi në Kuvend deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese brenda 60 ditëve.

Neni 46

Dorëheqja

1. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët paraqesin dorëheqjen me shkrim në Kuvend, si nga funksionet ekzekutive ashtu edhe si anëtarë të Këshillit, dhe qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e pasardhësve të tyre, por jo më gjatë se tre muaj nga data e paraqitjes së dorëheqjes.
2. Anëtarët e tjerë të Këshillit paraqesin dorëheqjen me shkrim në Kuvend dhe qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e pasuesit të tyre, por jo më gjatë se një muaj nga data e njoftimit të dorëheqjes.

Neni 47

Shpërblimi dhe përfitimet e tjera financiare

1. Këshilli përcakton politikat e shpërblimit për anëtarët e Këshillit dhe personelin e Bankës së Shqipërisë, të cilat duhet të garantojnë pavarësinë në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve të tyre, duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e këtyre funksioneve, nivelin e përgjegjësisë, nevojën për të ruajtur konkurrueshmërinë në tregun e punës, bazuar në analiza të tregut të kryera nga këshilltarë të pavarur me reputacion të lartë, si dhe objektivin për të punësuar profesionistë me kualifikim të lartë.
2. Politikat e mësipërme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, përcaktimin e strukturës së pagave, shtesave dhe përfitimeve financiare që lidhen me shëndetin, ngritjen e kompetencës profesionale, mbështetjen me kredi për strehim, si dhe krijimin dhe administrimin e fondit të pensionit.
3. Politikat e mësipërme nuk lidhen me fitimin e Bankës së Shqipërisë.
4. Pagat, shtesat dhe përfitimet e tjera financiare të anëtarëve të Këshillit dhe personelit nuk mund të ulen.
5. Këshilli rishikon periodikisht nivelet e pagave, shtesave dhe përfitimeve të tjera financiare. Rishikimi merr në konsideratë gjithashtu, por nuk kufizohet në, zhvillimet e indeksit të çmimeve të konsumit, tregut të banesave dhe zhvillimet e pagave në sektorin financiar. Paga bazë e personelit indeksohet çdo vit me normën vjetore të inflacionit.
6. Politika për pagat dhe shpërblimin e personelit përcaktohet, me propozimin e Guvernatorit, në

mënyrë të pavarur nga legjislacioni që rregullon skemat e pagave në administratën publike, në përputhje me parimin e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë.

Neni 48

Mbledhjet e Këshillit dhe procedurat e votimit

1. Këshilli mbledhet jo më pak se një herë në çdo muaj kalendarik.
2. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Guvernatori. Në rast mungese ose mospjesëmarrje për një shkak ligjor apo për të shmangur një rast konflikti interesi të Guvernatorit, mbledhjet e Këshillit thirren dhe drejtohen nga Zëvendësguvernatori i Parë. Në rast mungese ose mospjesëmarrje për një shkak ligjor apo për të shmangur një rast konflikti interesi të Guvernatorit dhe Zëvendësguvernatorit të Parë, mbledhjet e Këshillit thirren dhe drejtohen nga Zëvendësguvernatori i Dytë.
3. Mbledhjet e Këshillit mund të thirren gjithashtu me kërkesë me shkrim të tre anëtarëve të Këshillit ose, në rast urgjence, të dy anëtarëve të Këshillit.
4. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të propozojë përfshirjen e çështjeve në programin e ditës të mbledhjes së ardhshme të Këshillit.
5. Mbledhjet e Këshillit thirren duke u komunikuar të gjithë anëtarëve të Këshillit kohën, vendin dhe programin e ditës të mbledhjes, të paktën pesë ditë pune përpara datës së caktuar për mbledhje, përveç rasteve urgjente, kur mbledhja e Këshillit thirret me një afat më të shkurtër njoftimi. Çdo anëtar i pranishëm në mbledhjen e Këshillit ka të drejtën e një vote, e cila nuk mund të jetë abstenim.
6. Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe, mbledhjet e Këshillit zhvillohen me pjesëmarrjen e të paktën pesë anëtarëve të Këshillit, përfshirë Guvernatorin ose njërin prej Zëvendësguvernatorëve, dhe vendimet e Këshillit miratohen me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast barazie vote, kryetari i mbledhjes ka votën përcaktuese. Në rast se kuorumi i parashikuar në këtë pikë nuk arrihet për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante, Guvernatori ose, në mungesë të tij, Zëvendësguvernatori i Parë, mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, në të cilën vendimet merren me votën unanime të të gjithë anëtarëve të emëruar. Në rastin e vendimeve mbikëqyrëse, kuorumi dhe votimi unanimit duhet të përfshijnë të paktën tre anëtarë joekzekutivë.
7. Anëtari i Këshillit nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjeve për të cilat ka një pengesë ligjore ose konflikt interesi. Për efekt të kuoromit, ky anëtar konsiderohet jo prezent.
8. Asnjë vendim i Këshillit nuk konsiderohet i pavlefshëm vetëm për shkak të ekzistencës së vendeve vakante në Këshill.
9. Emërimi, shkarkimi ose përfundimi i mandatit të një anëtari nuk cenon vlefshmërinë e vendimeve të marra me pjesëmarrjen e anëtarit përkatës, për aq kohë sa plotësohet kuorumi.

Procedurat e Këshillit

1. Procedurat, informacioni dhe dokumentacioni i përdorur në procesin e vendimmarrjes në mbledhjet e Këshillit janë konfidenciale.
2. Për çdo mbledhje të Këshillit mbahet procesverbal, në të cilin pasqyrohen diskutimet, vendimet dhe rezultatet e votimit, dhe i cili nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe Sekretari i Këshillit. Procesverbali është konfidencial.
3. Sekretari i Këshillit emërohet nga Këshilli prej personelit drejtues të Bankës së Shqipërisë. Sekretari nuk është anëtar i Këshillit.
4. Këshilli mund të marrë vendime edhe nëpërmjet procedurës me shkrim, pa zhvilluar mbledhje. Vendimet e marra nëpërmjet procedurës me shkrim miratohen brenda pesë ditëve nga data e paraqitjes së propozimeve. Kjo vendimmarrje pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes së ardhshme të Këshillit.
5. Çdo anëtar i Këshillit mund të marrë pjesë dhe të votojë nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, përfshirë telekonferencën ose mjete të sigurta elektronike, të cilat garantojnë identifikimin e pjesëmarrësve, integritetin e diskutimeve dhe konfidencialitetin e informacionit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloret e brendshme. Pjesëmarrja dhe votimi në këtë mënyrë konsiderohen të barasvlershme me praninë fizike.

KAPITULLI XI

PERSONELI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Organizimi i brendshëm dhe marrëdhëniet e punësimit

1. Marrëdhëniet e punësimit të personelit të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, rekrutimin, largimin nga puna, të drejtat dhe detyrimet, rregullohen nga ky ligj, Kodi i Punës, si dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli dhe nuk i nënshtrohen legjislacionit për shërbimin civil.
2. Përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet shprehimisht ndryshe, Guvernatori vepron në cilësinë e punëdhënësit të personelit të Bankës së Shqipërisë, përfshirë emërimin, ngritjen në detyrë, vlerësimin, marrjen e masave disiplinore dhe largimin nga puna.
3. Marrëdhëniet e punësimit në Bankën e Shqipërisë bazohen, ndër të tjera, në parimet e meritokracisë, profesionalizmit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

KAPITULLI XII

DISPOZITA FINANCIARE

Neni 51

Llogaritë e rezervës

1. Banka e Shqipërisë krijon dhe mirëmban një rezervë të përgjithshme, niveli minimal i së cilës është i barabartë me 500% (pesëqind për qind) të kapitalit të nënshkruar. Këshilli mund të përcaktojë një nivel minimal më të lartë të rezervës së përgjithshme.
2. Rezerva e përgjithshme përdoret ekskluzivisht për mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë dhe, me miratimin e Këshillit, për rritjen e kapitalit të nënshkruar të Bankës së Shqipërisë. Ajo nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër.
3. Banka e Shqipërisë krijon dhe mirëmban llogari rivlerësimi për fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve. Shumat në llogaritë e rivlerësimit nuk përbëjnë fitim për t'u shpërndarë.
4. Këshilli mund të vendosë krijimin e llogarive të veçanta rezervë, përfshirë rezerva për rreziqe financiare specifike ose shpenzime të planifikuara.
5. Pavarësisht nenit 3, pika 4, Këshilli mund të vendosë rritjen e kapitalit të nënshkruar nga rezerva e përgjithshme e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 52

Fitimi dhe humbja

Fitimi apo humbja e Bankës së Shqipërisë llogaritet për çdo vit financiar si diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve të Bankës së Shqipërisë.

Neni 53

Shpërndarja e fitimit dhe mbulimi i humbjeve

1. Nga fitimi ose humbja e miratuar çdo vit financiar, veçohen shumat nga rivlerësimi i mjeteve dhe detyrimeve të cilat transferohen në llogarinë e rezervës së rivlerësimit.
2. Pas veçimit sipas pikës 1, fitimi shpërndahet sipas kësaj radhe:
 - a) për mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë;
 - b) në rezervën e përgjithshme, deri sa të arrijë minimumin e përcaktuar sipas këtij ligji;
 - c) në rezervat e veçanta të krijuara sipas nenit 51, në shumën e miratuar nga Këshilli;
 - d) pjesa e mbetur e fitimit transferohet në buxhetin e shtetit, pas miratimit të pasqyrave

financiare.

3. Nëse, në pasqyrat vjetore financiare të audituara të Bankës së Shqipërisë, kapitali është nën nivelin e kapitalit të nënshkruar:
 - a) asnjë fitim nuk transferohet në buxhetin e shtetit; dhe
 - b) me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, qeveria, brenda vitit financiar, rikapitalizon Bankën e Shqipërisë duke transferuar shumën e nevojshme në para ose në tituj të tregtueshëm me normë interesi dhe karakteristika të njëjta me ato të titujve të së njëjtës klasë që tregtohen në treg, të paktën në një shumë që përmbush kërkesën e nenit 3, pika 2, të këtij ligji.
4. Asnjë dispozitë ligjore ose marrëveshje nuk mund:
 - a) të detyrojë Bankën e Shqipërisë të transferojë fitimin në një shumë fikse ose sipas një formule fikse që nuk merr në konsideratë rezultatin financiar vjetor të audituara dhe nevojën për kapital dhe rezerva.
 - b) të lejojë shpërndarjen e shumave të regjistruara në rezervën e përgjithshme ose në llogaritë e rivlerësimit, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 54

Pasqyrat financiare

Banka e Shqipërisë përgatit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 55

Buxheti

1. Banka e Shqipërisë miraton buxhetin vjetor dhe buxhetin afatmesëm përpara fillimit të çdo viti financiar.
2. Këshilli miraton rregullat për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit.

Neni 56

Raporti vjetor dhe raportime të tjera

1. Banka e Shqipërisë i raporton ekskluzivisht Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për çështjet që lidhen me objektivat e Bankës së Shqipërisë një herë në vit dhe sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Brenda pesë muajve nga përfundimi i vitit financiar, Guvernatori i paraqet Kuvendit raportin vjetor dhe pasqyrat financiare vjetore të audituara e të miratuara, të shoqëruara me opinionin e audituesit të jashtëm të pavarur.

3. Raporti vjetor jep informacion mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe politikën monetare dhe aktivitetin e saj në mbështetje të stabilitetit financiar për vitin e kaluar.
4. Banka e Shqipërisë publikon raportin vjetor dhe pasqyrat financiare vjetore të audituara pas paraqitjes së tyre në Kuvend.
5. Përveç raportit vjetor sipas pikës 3 të këtij neni, Banka e Shqipërisë harton, miraton dhe publikon raporte periodike për vlerësimin e arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit të sistemit financiar.
6. Raportet sipas këtij neni u vihen në dispozicion pa pagesë palëve të interesuara.

Neni 57

Auditi i brendshëm

1. Këshilli miraton Rregulloren e Auditit të Brendshëm, e cila përcakton misionin, kompetencat, pavarësinë funksionale, fushën e veprimtarisë dhe standardet profesionale të funksionit të auditit të brendshëm, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, përfshirë ato të bankave qendrore.
2. Auditi i brendshëm në Bankën e Shqipërisë kryhet nga Drejtori i Auditit të Brendshëm, i cili mbështetet nga Departamenti i Auditit të Brendshëm.
3. Drejtori i Auditit të Brendshëm të Bankës së Shqipërisë emërohet nga Këshilli, me propozim të Guvernatorit, në përputhje me këtë ligj.
4. Drejtori i Auditit të Brendshëm duhet të ketë integritet të lartë profesional dhe përvojë të gjerë në kontrollin e brendshëm, kontrollin financiar ose kontabilitet. Kërkesat për përshtatshmëri, papajtueshmëri dhe integritet, të zbatueshme për anëtarët e Këshillit sipas këtij ligji, zbatohen, për aq sa janë të zbatueshme, edhe për emërimin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm.
5. Drejtori i Auditit të Brendshëm emërohet për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi. Drejtori i Auditit të Brendshëm gëzon të njëjtin status, të njëjtin shpërblim dhe të njëjtat përfitime nga marrëdhënia e punës si Zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë.
6. Drejtori i Auditit të Brendshëm i ushtron detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe objektive. Gjatë ushtrimit të këtyre detyrave, Drejtori i Auditit të Brendshëm nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime nga Guvernatori ose Zëvendësguvernatorët.
7. Drejtori i Auditit të Brendshëm i raporton funksionalisht dhe drejtpërdrejt Këshillit, si dhe i paraqet Komitetit të Auditit raportet e auditimit, së bashku me informacionin mbi çështjet materiale që lidhen me kuadrin e kontrollit të brendshëm, menaxhimin e rrezikut dhe qeverisjen e Bankës së Shqipërisë.
8. Drejtori i Auditit të Brendshëm i propozon Guvernatorit personelin e departamentit të kontrollit të Brendshëm për punësim.
9. Drejtori i Auditit të Brendshëm mund t'i paraqesë Këshillit dorëheqjen e tij me njoftim me shkrim të paktën një muaj përpara datës së propozuar për largimin nga detyra.
10. Drejtori i Auditit të Brendshëm mund të shkarkohet nga detyra vetëm me vendim të Këshillit, me

propozim të arsyetuar të Guvernatorit, dhe vetëm nëse ekzistojnë rrethana të barasvlershme me shkaqet e shkarkimit të parashikuara në nenin 45 të këtij ligji, për aq sa ato janë të zbatueshme për pozicionin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm. Vendimi për shkarkim duhet të përcaktojë arsyet e shkarkimit dhe të respektojë garancitë e nevojshme për ruajtjen e pavarësisë funksionale të funksionit të auditit të brendshëm.

11. Inspektori i Përgjithshëm në detyrë vazhdon të ushtrojë funksionin deri në përfundim të mandatit të miratuar nga Kuvendi. Të gjitha të drejtat e dhëna nga ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në përfundimin e mandatit.

Neni 58

Auditimi i jashtëm

1. Llogaritë, regjistrat dhe pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë auditohen të paktën një herë në vit nga shoqëri audituese të pavarura, me reputacion të mirë dhe përvojë të njohur ndërkombëtare në auditimin e institucioneve të mëdha financiare apo bankave qendrore.
2. Audituesi i jashtëm përzgjidhet nëpërmjet një procedure prokurimi të Bankës së Shqipërisë, transparente, konkurruese dhe jodiskriminuese, në përputhje me rregulloret e Këshillit.
3. Në përfundim të kësaj procedure prokurimi, Këshilli emëron audituesin e jashtëm, duke marrë në konsideratë rekomandimin e Komitetit të Audit.
4. Audituesi i jashtëm mund të emërohet vetëm nëse shoqëria e auditimit është e licencuar, e regjistruar dhe i nënshtrohet sistemeve të mbikëqyrjes publike dhe të sigurimit të cilësisë në përputhje me legjislacionin përkatës.
5. Audituesi i jashtëm dhe ortakët, punonjësit dhe rrjeti i tij duhet të jenë plotësisht të pavarur nga Banka e Shqipërisë.
6. Një shoqëri auditimi mund të përzgjidhet fituese në dy procedura prokurimi të njëpasnjëshme për auditimin e pasqyrave financiare, me kusht që të ketë ndryshuar ortakun kryesor. Në asnjë rast, ky shërbim nuk mund të kryhet nga e njëjta shoqëri auditimi për një periudhë kohore më të gjatë se 10 vite. .
7. Audituesi i jashtëm informon Komitetin e Auditit mbi rezultatet e auditimit, çështjet kryesore të auditimit dhe çështjet që lidhen me raportimin financiar të Bankës së Shqipërisë.
8. Audituesi i jashtëm mund të largohet vetëm për shkaqe të justifikuara. Çdo përfundim i parakohshëm i mandatit bëhet publik.
9. Opinioni i audituesit publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore të audituara.

Neni 59

Komiteti i Auditit

1. Këshilli krijon Komitetin e Auditit si organ këshillimor për mbikëqyrjen e integritetit të raportimit financiar, efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, administrimit të rrezikut dhe procesit të auditimit të jashtëm të Bankës së Shqipërisë.
2. Komiteti i Auditimit përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit, të cilët preferohen të kenë përvojë në fushën e auditimit ose të menaxhimit të rrezikut. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit të Auditimit.
3. Komiteti i Auditit mund të këshillohet nga një ekspert i jashtëm në fushën e auditimit ose administrimit të rrezikut.

Neni 60

Auditimi publik i Bankës së Shqipërisë

1. Pa cenuar pavarësinë e Bankës së Shqipërisë dhe auditin e jashtëm të parashikuar në nenin 58 të këtij ligji, Kontrolli i Lartë i Shtetit autorizohet të auditojë vetëm operacionet dhe veprimtaritë administrative të Bankës së Shqipërisë, përfshirë ato që lidhen me aktivet, pajisjet, shërbimet mbështetëse, burimet njerëzore dhe administrimin.
2. Ky audit kufizohet vetëm në shqyrtimin e ligjshmërisë dhe efikasitetit operacional të veprimtarive administrative të Bankës së Shqipërisë. Ai nuk shtrihet në vlerësimin e arritjes së objektivave ligjorë të Bankës së Shqipërisë, në formulimin ose zbatimin e politikës monetare, në ushtrimin e funksioneve të saj themelore si bankë qendrore dhe as në auditimin e pasqyrave të saj financiare, të cilat i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur në përputhje me nenin 58 të këtij ligji dhe legjislacionin përkatës vendas që rregullon auditimin.
3. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk duhet t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, asnjë udhëzim Bankës së Shqipërisë, organeve të saj drejtuese ose anëtarëve të tyre.
4. E drejta për informacion e Kontrollit të Lartë të Shtetit kufizohet vetëm në ato dokumente dhe informacione që janë të nevojshme për qëllimet e auditimit të veprimtarisë administrative sipas këtij neni. Dokumentet dhe informacioni që lidhen me politikën monetare, stabilitetin financiar, operacionet e tregut ose të dhënat individuale bankare përjashtohen nga e drejta për tu njohur.
5. Anëtarët dhe personeli i Kontrollit të Lartë të Shtetit u nënshtrohen detyrimeve të rrepta për ruajtjen e sekretit profesional, të barasvlershme me ato që zbatohen për personelin e Bankës së Shqipërisë, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe pas përfundimit të saj.
6. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të paraqesë komente dhe kundërshtime ndaj projekt-raportit të auditimit. Banka e Shqipërisë nuk është e detyruar të paraqesë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

KAPITULLI XIII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 61

Aktet ligjore

1. Banka e Shqipërisë nxjerr akte normative apo akte të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrave të saj.
2. Aktet normative hyjnë në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe; akte individuale hyjnë në fuqi me njoftimin e tyre, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

Neni 62

Masat administrative dhe sanksionet

1. Banka e Shqipërisë merr masa administrative dhe vendos sanksione ndaj çdo personi fizik apo juridik që konstatohet se ka shkelur këtë ligj ose ligje të tjera nën juridiksionin e Bankës së Shqipërisë, si edhe akte të tjera normative të dala nga këto ligje.
2. Masat përfshijnë, sipas rastit, paralajmërime, urdhra me shkrim, gjoba, masa korrigjuese, pezullime ose largime nga detyra të administratorëve, heqje licence, si edhe masa të tjera të parashikuara në këtë ligj ose në legjislacionin përkatës.
3. Masat vendosen në mënyrë proporcionale, efektive dhe parandaluese, duke mbajtur parasysh natyrën, rëndësinë, kohëzgjatjen dhe përsëritjen e shkeljes.
4. Të gjitha masat dhe sanksionet e përshkruara në këtë nen, të vendosura nga Banka e Shqipërisë, konsiderohen **urdhra ekzekutimi** sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, dhe ekzekutohen nga përmbaruesit sipas ligjit.

Neni 63

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Këshillit, stafi i Bankës së Shqipërisë dhe çdo person që vepron në emër të saj ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri dhe integritet. Kanë detyrim të respektojnë rregullat dhe dispozitat ligjore që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit. Ata duhet të parandalojnë, raportojnë dhe, kur është e mundur, zgjidhin çdo konflikt interesi aktual, të mundshëm ose në dukje, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli.
2. Anëtarët e Këshillit duhet t'i raportojnë plotësisht dhe menjëherë Këshillit çdo interes privat që

lidhet me çështje në shqyrtim ose që mund të shkaktojë një konflikt interesi. Anëtari i Këshilli që deklaron një interes të tillë dorëhiqet nga diskutimi dhe votimi i çështjes përkatëse; prania e tij ose e saj nuk llogaritet për kuorumin.

3. Ndalohet kërkimi, pranimi ose marrja e dhuratave, favoreve apo përfitimeve të tjera që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tyre, përveç rasteve të lejuara shprehimisht nga ligji dhe nga rregullat e Kodit të Etikës të miratuara nga Këshilli.
4. Me përfundimin e ushtrimit të detyrës, ish-Guvernatorët dhe ish- Zëvendësguvernatorët nuk mund të mbajnë poste apo të ofrojnë shërbime në subjekte të licensuara ose të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, për një periudhë prej një viti ose më të gjatë, sipas parashikimeve të ligjit përkatës “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Këshilli ofron kompensimin e duhur gjatë periudhës së kufizimit pas largimit nga detyra.
5. Shkelja e këtyre detyrimeve nga një punonjës përbën shkelje të rëndë disiplinore dhe mund të passjellë marrjen e masave disiplinore, përfshirë largimin nga puna, pa cenuar përgjegjësitë sipas legjislacionit në fuqi dhe pasi Komisioni i Etikës, i ngritur sipas përcaktimeve të këtij neni, të japë një opinion.
6. Banka e Shqipërisë miraton rregulla që përcaktojnë:
 - a) procedurat për parandalimin, deklarimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit, si dhe për pranimin e dhuratave;
 - b) zbatimin me nivele të detyrimeve ndaj anëtarëve të Këshillit, drejtuesve të lartë, punonjësve që ushtrojnë funksione sensitive dhe punonjësve të tjerë;
 - c) emërimin, mandatin, linjën e raportimit dhe garantimin e pavarësisë së Komisionit të Etikës, përgjegjësinë për dhënien e udhëzimeve, monitorimin e pajtueshmërisë dhe trajtimin e raportimeve; dhe
 - d) mbrojtjen nga çdo lloj forme hakmarrjeje ndaj personave që raportojnë, në mirëbesim, shkelje të dyshimta të këtij neni.

Neni 64

Tarifa dhe komisione

1. Banka e Shqipërisë mund të vendosë tarifa për shërbimet që u ofron palëve të treta, për të mbuluar kostot e saj.
2. Tarifat miratohen nga Këshilli dhe publikohen.

Neni 65

Veprimtari të ndaluara

Përveç rasteve kur autorizohet shprehimisht me ligj, Banka e Shqipërisë:

- a) nuk jep ndihmë financiare, dhurata monetare, hua të drejtpërdrejta ose donacione;

- b) nuk ofron kredi ose financim me kushte, nuk blen hua ose kredi, nuk mund të jetë bashkëkreditore dhe të marrë pjesë në instrumente të tjera të borxhit;
- c) nuk subvencionon borxhe ose detyrime të kushtëzuara të ndonjë forme, përveç rasteve kur kjo bëhet rreptësisht për menaxhimin e aktiveve të veta.
- d) nuk merret me veprimtari tregtare, nuk blen aksione të shoqërive tregtare ose të subjekteve të ndryshme, duke përfshirë edhe aksionet e institucioneve financiare, si dhe nuk mund të jetë bashkëpronare në veprimtari financiare, tregtare, bujqësore, industriale ose veprimtari tjetër.

Neni 66

Përfshirja tatimore

Banka e Shqipërisë përfshihet nga të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat.

Neni 67

Marrëdhënia me legjislacionin

Dispozitat e këtij Ligji kanë epërsi dhe përparësi në rast mospërputhjeje ndaj ligjeve të tjera.

Neni 68

Sekreti profesional dhe konfidencialiteti

1. Për qëllimet e këtij ligji “informacion konfidencial” nënkupton çdo informacion jo publik që merret ose prodhohet gjatë ushtrimit të funksioneve të ngarkuara Bankës së Shqipërisë me këtë ligj, me Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë ose me çdo ligj tjetër, duke përfshirë informacion me natyrë mbikëqyrëse, raportet e inspektimit, informacionin që lidhet me licencimin, autorizimin dhe zbatimin, korrespondencën me subjektet e mbikëqyrura, diskutimet e brendshme, të dhënat statistikore me të cilat mund të identifikohen subjektet, si dhe çdo informacion tjetër në të cilin publiku nuk ka qasje dhe që, duke mos qenë në formë të përmbledhur, u referohet personave ose subjekteve të caktuar të identifikueshëm.
2. Anëtarët e Këshillit, stafi, konsulentët, audituesit dhe çdo person tjetër që punon ose ka punuar për ose në emër të Bankës së Shqipërisë duhet të ruajnë sekretin profesional në lidhje me të gjithë informacionin konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Legjislacioni përkatës që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve zbatohet pavarësisht dispozitave të këtij neni.
3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional vazhdon edhe pas përfundimit të mandatit, marrëdhënies së punësimit ose angazhimit.
4. Pavarësisht përcaktimit në pikën 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund të japë informacion

konfidencial vetëm në rrethanat dhe për qëllimet e përcaktuara më poshtë:

- a) autoriteteve mbikëqyrëse vendase dhe të huaja si edhe bankave qendrore, për qëllimin e ushtrimit të funksioneve të tyre, me kusht që këto autoritete t'i nënshtrohen detyrimeve të barasvlershme për ruajtjen e sekretit profesional dhe, sipas rastit, mbi bazën e memorandumeve të mirëkuptimit të lidhura në përputhje me nenin 69;
 - b) Bankës Qendrore Evropiane, Autoritetit Bankar Evropian, Bordit Evropian për Rrezikun Sistemik, Bordit Unik të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, si dhe institucioneve dhe organeve të tjera të Bashkimit Evropian, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe kërkesat për ruajtjen e sekretit profesional;
 - c) autoriteteve kombëtare të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe skemave të garantimit të depozitave, me qëllim planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose mbrojtjen e depozituesve;
 - d) prokurorive dhe autoriteteve ligj zbatuese, kur Banka e Shqipërisë, anëtarët e Këshillit të saj, administratorët ose punonjësit e saj dyshojnë se një subjekt i mbikëqyrur ose çdo person tjetër i lidhur me veprimtarinë e një subjekti të mbikëqyrur ka kryer një vepër penale.
 - e) audituesit të jashtëm të Bankës së Shqipërisë dhe subjekteve të mbikëqyrura, në masën e duhur për kryerjen e funksioneve të tyre të auditimit dhe me kusht që t'u nënshtrohen detyrimeve të barasvlershme për ruajtjen e konfidencialitetit;
 - f) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen makroprudenciale, në masën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre;
 - g) agjencive ose institucioneve përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për qëllim të ushtrimit të funksioneve të tyre sipas legjislacionit në fuqi;
 - h) në procese gjyqësore ku Banka e Shqipërisë është palë, në masën e nevojshme për mbrojtjen ose zbatimin e të drejtave të Bankës; me pëlqimin paraprak me shkrim të personit ose subjektit të cilit i përket informacioni konfidencial;
 - i) të përmbledhur ose në formë të përgjithshme, në mënyrë që persona ose subjekte të caktuar të mos mund të identifikohen;
 - j) institucioneve financiare ndërkombëtare, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi ose nga marrëveshje ndërkombëtare;
 - k) për qëllime të procedimeve penale, kur kërkohet nga prokurori ose me vendim gjyqësor të formës së prerë sipas ligjit.
5. Çdo person ose subjekt që vihet në dijeni të një informacioni konfidencial sipas pikës 4 të këtij neni, ka detyrimin të ruajë sekretin profesional të barasvlershëm me ato të përcaktuara në këtë nen. Banka e Shqipërisë sigurohet nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit ose marrëveshjeve të tjera që informacioni konfidencial i publikuar të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është komunikuar dhe të mos i zbulohet më tej palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.
6. Informacioni konfidencial, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohet vetëm nga ky nen dhe nga çdo dispozitë tjetër e këtij ligji; kjo e fundit ka përparësi ndaj çdo dispozite kundërshtuese në ligje të tjera, përfshirë Ligjin për të Drejtën e Informimit, dhe njohjes me dokumente publike dhe

legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Asnjë person ose autoritet publik, përfshirë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, nuk mund të urdhërojë ose të detyrojë publikimin e informacionit që është konfidencial sipas këtij neni. Dispozitat e përgjithshme për qasje në informacionin publik nuk zbatohen për informacionin konfidencial, sipas përkufizimit në pikën 1 të këtij neni.

7. Shkelja e detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional sipas këtij neni përbën:
 - a) për stafin e Bankës së Shqipërisë, shkelje të rëndë disiplinore që passjell masa disiplinore, pa cenuar përgjegjësinë sipas legjislacionit në fuqi dhe pas marrjes së mendimit të detyrueshëm të Komisionit të Etikës të parashikuar në nenin 63 të këtij ligji.
 - b) për konsulentët, audituesit dhe çdo person tjetër që vepron në emër të Bankës e Shqipërisë ose është i angazhuar prej saj, shkak për përfundimin e angazhimit, pa cenuar përgjegjësinë sipas legjislacionit civil dhe penal në fuqi.
8. Guvernatori miraton rregulla dhe udhëzime të nevojshme për klasifikimin e dokumenteve dhe informacionit që mbahet nga Banka e Shqipërisë, duke përcaktuar kriteret e klasifikimit, procedurat e trajtimit të informacionit, rregullat për ruajtjen dhe transmetimin, të drejtat e njohjes dhe rregullat për deklasifikimin.
9. Guvernatori mund të miratojë rregulla të tjera që specifikojnë procedurat për zbatimin e këtij neni, përfshirë kushtet dhe modalitetet për publikimet e lejuara sipas pikës 4 të këtij neni, si dhe kriteret për përcaktimin e barasvlershmërisë së detyrimeve për ruajtjen e sekretit profesional të autoriteteve që marrin informacionin.

Neni 69

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Në përmbushje të objektivave dhe në ushtrim të detyrave të saj, Banka e Shqipërisë shkëmben informacion dhe kryen inspektive të përbashkëta me autoritetet mbikëqyrëse vendase dhe të huaja në sektorin bankar dhe financiar, bankat e tjera qendrore, institucionet financiare ndërkombëtare, agjencitë ose institucionet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ose institucione të tjera të njohura me ligj, mbi bazën e reciprocitetit ose sipas kërkesave të ligjit, marrëveshjeve ndërkombëtare ose memorandumeve të mirëkuptimit.
2. Kur është e nevojshme për garantimin e efektivitetit të politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritete të tjera publike.
3. Banka e Shqipërisë mund të kryejë inspektive në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.
4. Shkëmbimi i informacionit me palët e përmendura në pikën 1 kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara nga pala që ka dhënë informacionin dhe në respektim të detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji.
5. Informacioni i marrë nga, ose i dhënë palëve të përmendura në pikën 1, i nënshtrohet, më së paku, detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji dhe nuk mund

të publikohet pa miratimin paraprak me shkrim të palës nga e cila është marrë informacioni, as të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç qëllimit për të cilin është bërë publik.

6. Banka e Shqipërisë mund të lidhë memorandume mirëkuptimi me palët e përmendura në pikën 1, me qëllim përcaktimin e kuadrit, kushteve dhe procedurave për shkëmbimin e informacionit konfidencial, duke përfshirë masat mbrojtëse të zbatueshme për përdorimin dhe zbulimin e mëtejshëm të këtij informacioni.

Neni 70

E drejta preferenciale

1. Banka e Shqipërisë gëzon një të drejtë preferenciale parësore të pakushtëzuar për shlyerjen e çdo pretendimi që lind nga ushtrimi i detyrave të saj, mbi çdo shumë monetare, tituj ose pasuri tjetër që ajo mban për llogari të debitorëve të saj ose si kolateral për garantimin e këtyre pretendimeve, në momentin kur bëhen të pagueshme.
2. Banka e Shqipërisë e ushtron këtë të drejtë preferenciale duke kompensuar shumat monetare të mbajtura në llogarinë e debitimeve të saj dhe duke shitur tituj ose pasuri të tjera, pa vonesa të panevojshme dhe në një mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja tregtare, duke u kompensuar me të ardhurat e shitjes pas zbritjes së kostove që lidhen drejtpërdrejt me këtë shitje.
3. E drejta preferenciale sipas këtij neni ushtrohet pavarësisht fillimit të procedurave të falimentimit, riorganizimit, likuidimit ose procedurave të tjera kolektive ndaj debitorëve të saj, në masën e nevojshme për të mbrojtur ushtrimin efektiv të detyrave ligjore të Bankës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk i nënshtrohet asnjë forme pezullimi, kufizimi apo autorizimi gjyqësor ose administrativ që do të cenonte ushtrimin e saj.
4. Asnjë pretendim konkurrues, masë e përkohshme sigurimi, vendim gjyqësor ose administrativ, apo ndonjë efekt tjetër i procedurave të falimentimit nuk mund të pengojë, pezullojë ose vonojë ushtrimin nga Banka e Shqipërisë të së drejtës së saj preferenciale, pa cenuar të drejtat reale të fituara ligjërisht nga palët e treta përpara krijimit të pretendimit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 71

Rishikimi gjyqësor dhe përgjegjësia

1. Gjatë proceseve gjyqësore apo në arbitrazhe kundër Bankës së Shqipërisë, gjykata/trupa gjykuese shqyrton vetëm ligjshmërinë e veprimeve ose mosveprimeve të kontestuara, në bazë faktesh dhe ligjesh të zbatueshme, pa i hyrë vlerësimit të meritave të politikave, vendimmarrjes ose kompetencave të Bankës së Shqipërisë.
2. Anëtar i Këshillit, stafi ose çdo person tjetër i autorizuar nga Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për mosveprimet ose veprimet e ndërmarra gjatë kryerjes së detyrave të tyre, në përputhje me këtë ligj ose ligje dhe akte normative të tjera të nxjerra në zbatim të tyre, përveç

rasteve kur provohet se mosveprimi ose veprimi është kryer me qëllim të kundraligjshëm ose si rezultat i një pakujdesie të rëndë.

3. Banka e Shqipërisë mbulon shpenzimet për mbrojtjen ligjore të personave të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, në çdo proces gjyqësor ose administrativ që lidhet me ushtrimin ose ushtrimin e pretenduar të detyrave të tyre, brenda qëllimit të punësimit ose angazhimit të tyre.
4. Shpenzimet ligjore të mbuluara sipas pikës 3 të këtij neni do të rimbursohen nga përfituesit nëse ata shpallen përgjegjës ose dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprimet ose mosveprimet objekt i procedimit në fjalë në rastet kur vërtetohet se veprimi ose mosveprimi është ndërmarrë me qëllim të gabuar ose si pasojë e një pakujdesie serioze.

Neni 72

Dispozita të veçanta për administratorët

1. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët nuk mund të arrestohen ose të privohen nga liria në ndonjë formë, as t'i nënshtrohen kontrollit personal apo të banesës, pa autorizimin e Gjykatës Kushtetuese, përveç rasteve kur kapen në flagrancë ose ndërsa janë në ndjekje menjëherë pas kryerjes së një krimi.
2. Me përjashtim të rastit të specifikuar në pikën 1 të këtij neni, prokurori i çështjes duhet të kërkojë menjëherë autorizimin e Gjykatës Kushtetuese përpara se të kryejë arrestimin, kontrollin personal ose të banesës së Guvernatorit dhe Zëvendësguvernatorëve. Gjykata Kushtetuese merr vendim për autorizimin brenda dy javëve nga data kur i paraqitet çështja. Në rast se Gjykata Kushtetuese nuk vendos brenda këtij afati kohor, kërkesa për autorizim konsiderohet e refuzuar.

Neni 73

Imuniteti i pronës, rezervës dhe transaksioneve të tjera

1. Ndaj Bankës së Shqipërisë apo pasurive të saj ku përfshihen mjete monetare, kredi, depozita, tituj, si dhe të ardhura që rrjedhin prej tyre, nuk mund të vendosen masa sigurimi ose ekzekutimi, përfshirë sekuestro, ngrirje ose masa të tjera të ngjashme, përpara shpalljes dhe njoftimit të një vendimi gjyqësor ose arbitrazhi të formës së prerë.
2. Pavarësisht përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, fondet që përbëjnë rezervën valutore të Bankës së Shqipërisë nuk preken nga asnjë lloj sekuestrimi, pezullimi të veprimtarive me llogaritë, mase sigurimi ose ekzekutimi, nga autoritetet gjyqësore, të arbitrazhit ose administrative, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Operacionet dhe veprimtaritë e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për realizimin e objektivave të saj nuk konsiderohen veprimtari tregtare dhe nuk i nënshtrohen sekuestrimit, ose masave të tjera të ngjashme.
4. Gjykatat në Republikën e Shqipërisë ose të huaja, organet e arbitrazhit dhe autoritetet

administrative janë të detyruara të njohin dhe të respektojnë imunitetin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me këtë nen.

5. Asnjë masë ekzekutimi, e përkohshme ose përfundimtare, nuk mund të merret ndaj pasurive të përmendura në këtë nen pa pëlqimin e shprehur të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të arit dhe të SDR-së, për të cilat heqja dorë nga imuniteti nuk lejohet.

Neni 74

Mbrojtja e aktiveve, personelit dhe vazhdimësia e funksioneve

1. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet strukturave të saj organizative, organizon dhe garanton mbrojtjen e personelit, objekteve, aktiveve, kartëmonedhave dhe monedhave, dokumentacionit dhe informacionit, infrastrukturës, sistemeve dhe vlerave monetare që administrojnë, me qëllim që të sigurojë ushtrimin e pandërprerë dhe të sigurt të detyrave që i janë ngarkuar me ligj.
2. Banka e Shqipërisë miraton dhe zbaton masa për vazhdimësinë operacionale dhe menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme, duke përfshirë rrethanat që mund të rrezikojnë stabilitetin financiar, funksionimin e sistemeve të pagesave ose ushtrimin e detyrave ligjore.
3. Për arritjen e objektivave të parashikuara në këtë nen, Banka e Shqipërisë merr masa organizative, teknike dhe administrative, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të posaçme për sigurinë fizike dhe mbrojtjen elektronike, në përputhje me legjislacionin përkatës.
4. Këshilli miraton rregullat për organizimin dhe funksionimin e masave të sigurisë dhe të planeve të vazhdimësisë.
5. Në rast rrethanash të jashtëzakonshme që cenojnë ose rrezikojnë seriozisht ushtrimin e detyrave të saj, Banka e Shqipërisë mund të marrë masa të përkohshme dhe proporcionale për të garantuar stabilitetin institucional dhe operacional.
6. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me institucionet kompetente shtetërore për çështje që lidhen me sigurinë kombëtare dhe menaxhimin e krizave, në masën që ato lidhen me ushtrimin e detyrave të saj.

Neni 75

Ankimi gjyqësor

1. Çdo person juridik ose fizik, i prekur nga shkeljet e pretenduara të këtij ligji nga Banka e Shqipërisë, ka të drejtë t'i ankimojë ato në gjykatën e apelit.
2. Pavarësisht përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, akti i Bankës së Shqipërisë zbatohet pa kufizim derisa gjykata të japë vendimin e saj.

Neni 76

Prokurimi në Bankën e Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë është e përjashtuar nga zbatimi i rregullave dhe dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik.
2. Këshilli Mbikëqyrës miraton rregulloret e nevojshme dhe përcakton politikat që normojnë procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë, bazuar në parimet dhe standardet e njohura si praktikatat më të mira.

KREU XIV

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Neni 77

Dispozita të përgjithshme

1. Banka e Shqipërisë është pjesë përbërëse e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.
2. Në përputhje me dispozitat e Traktatit për Bashkimin Evropian, Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane (në vijim: BQE), rregulloreve të Bashkimit Evropian që janë drejtpërdrejt të zbatueshme, si dhe dispozitave të këtij ligji, Banka e Shqipërisë ushtron veprimtarinë e saj për realizimin e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.
3. Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë në lidhje me Sistemin Evropian të Bankave Qendrore nuk i nënshtrohet auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 78

Pavarësia brenda Sistemit Evropian të Bankave Qendrore

1. Në përputhje me nenin 130 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe nenin 7 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj, në Traktatin për Bashkimin Evropian, në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe në Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë dhe anëtarët e Këshillit të saj nuk kërkojnë dhe nuk marrin udhëzime nga institucionet, organet, zyrat ose agjencitë e Bashkimit Evropian, nga qeveria e ndonjë shteti anëtar apo nga çdo organ tjetër.
2. Institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, si dhe qeveritë e shteteve anëtare, respektojnë pavarësinë e Bankës së Shqipërisë dhe nuk përpiqen të ushtrojnë ndikim mbi anëtarët

e Këshillit ose personelin e Bankës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk cenojnë kompetencat e Bankës Qendrore Evropiane ndaj Bankës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 79

Objektivat pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian

1. Banka e Shqipërisë, pa cenuar objektivin e saj parësor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe objektivin e saj për ruajtjen e stabilitetit financiar, mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për arritjen e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme, si dhe politikat e përgjithshme ekonomike të Bashkimit Evropian, me qëllim që të kontribuojë në arritjen e objektivave të Bashkimit Evropian.
2. Banka e Shqipërisë vepron në përputhje me parimin e një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar një shpërndarje efikase të burimeve, në përputhje me parimet e përcaktuara në Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.
3. Banka e Shqipërisë respekton objektivat dhe përmbush detyrat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, rregulloret e Bashkimit Evropian dhe këtë ligj.

Neni 80

Operacionet e tregut të hapur dhe të kredisë

1. Për të respektuar objektivat dhe për të përmbushur detyrat e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, si dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë mund të veprojë në tregjet financiare duke blerë dhe shitur në mënyrë përfundimtare (me dorëzim të menjëhershëm ose në të ardhmen), nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes (*repo*), si dhe duke dhënë ose marrë hua kërkesa, instrumente të tregtueshme, të emërtuara në euro ose në çdo monedhë tjetër, si dhe metale të çmuara.
2. Banka e Shqipërisë mund të kryejë gjithashtu operacione kredie me institucionet e kreditit dhe pjesëmarrës të tjerë të tregut, përfshirë dhënien e kredive kundrejt kolateralit të mjaftueshëm.

Neni 81

Funksioni këshillimor i Bankës Qendrore Evropiane

Projektligjet dhe projektaktet e tjera normative që bëjnë pjesë në fushat e kompetencës së Bankës Qendrore Evropiane i dërgohen Bankës Qendrore Evropiane për dhënie mendimi, në përputhje me

nenin 127, pika 4, dhe nenin 282, pika 5, të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Neni 82

Mbrojtja e kartëmonedhave dhe monedhave kundër falsifikimit

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti kombëtar kompetent për mbrojtjen e euros kundër falsifikimit dhe ushtron funksionet e saj në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian për kryerjen e veprimtarive që lidhen me mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave euro kundrejt falsifikimit dhe shpërndarjes së kundërligjshme të tyre.
2. Për të siguruar mbrojtjen efektive të kartëmonedhave dhe monedhave ndaj falsifikimit dhe shpërndarjes së kundërligjshme, si dhe në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian, Banka e Shqipërisë mund të nxjerrë akte normative për zbatimin e tyre. Aktet normative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni duhet të jenë plotësisht në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 83

Kompetencat ndaj institucioneve të kreditit

Banka e Shqipërisë licencon dhe revokon licencat e institucioneve të kreditit, mbikëqyr veprimtarinë e tyre, nxjerr rregullore dhe akte të tjera për rregullimin e veprimtarisë së tyre dhe përcaktimin e standardeve për ushtrimin e sigurt dhe të shëndoshë të kësaj veprimtarie, si dhe ushtron kompetenca të tjera në përputhje me rregulloret e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kreditit.

Neni 84

Ndalimi i kreditimit të sektorit publik

1. Në përputhje me nenin 123 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Banka e Shqipërisë nuk mund të japë kredi në formën e kredisë kufi (overdraft) ose çdo lloj tjetër lehtësie kredie në favor të Qeverisë, organeve dhe organizatave të tjera shtetërore të Republikës së Shqipërisë, njësive të vetëqeverisjes vendore, personave, kur themeluesi ose pronari shumicë i të cilëve është shteti ose organ e vetëqeverisjes vendore, është shteti ose një njësi e vetëqeverisjes vendore, institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit Evropian, qeverive qendrore të shteteve anëtare, autoriteteve rajonale, vendore ose autoriteteve të tjera publike në shtetet anëtare, organeve të tjera të së drejtës publike dhe ndërmarrjeve publike të Republikës së Shqipërisë ose të shteteve anëtare, si dhe ndalohet të blejë drejtpërdrejt prej tyre instrumente të borxhit.
2. Ndalimi i kreditimit të sektorit publik, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet në rastet përjashtimore të përcaktuara në nenin 123, pika 2, të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Neni 85

Lehtësia e likuiditetit për institucionet e kreditit

1. Në rast të një nevoje urgjente, të paparashikuar dhe të përkohshme të një institucioni krediti për likuiditet, Banka e Shqipërisë, me qëllim që të kontribuojë në përputhje me objektivin e saj për ruajtjen e stabilitetit financiar, mund t'i japë një hua afatshkurtër një institucioni krediti, me aftësi paguese të detyrimeve të tij, me kusht që huaja të jetë e siguruar me kolateral të përshtatshëm.
2. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së huas të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 86

Anëtarësimi në Këshillin e Përgjithshëm të Bankës Qendrore Evropiane

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 87

Shkarkimi nga detyra

1. Anëtari i Këshillit shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit të tij vetëm nëse konstatohen rrethanat e përcaktuara në Nenin 14, pika 2, të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.
2. Me shumicën e votave të anëtarëve të tij, Këshilli përcakton rrethanat e konstatuara për shkarkimin nga detyra të një anëtari të Këshillit dhe njofton menjëherë Kuvendin për këtë qëllim, dhe propozon shkarkimin nga detyra të anëtarit të Këshillit.
3. Në rast se Kuvendi vlerëson se Këshilli nuk ka arritur të përcaktojë ekzistencën e kushteve për shkarkim nga detyra, Kuvendi ngre një komision të përbërë nga një kryetar, i cili ka kryer ose kryen funksione gjyqësore, dhe të paktën dy anëtarë të tjerë, njëri prej të cilëve duhet të jetë ekspert në fushën e bankave ose financave, komision që do të shqyrtojë çështjen dhe do t'i paraqesë Kuvendit një raport me rekomandime.
4. Guvernatori i shkarkuar nga detyra ka të drejtë ta referojë vendimin për shkarkim në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian, ndërsa anëtarët e tjerë të Këshillit mund të ngrenë pretendimet e tyre në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 88

Dorëzimi i informacionit dhe të dhënave sekrete

1. Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë mund t'u paraqesë Bankës Qendrore Evropiane

dhe institucioneve e organeve të tjera të Bashkimit Evropian informacione dhe të dhëna që konsiderohen sekrete.

2. Informacionet dhe të dhënat që konsiderohen sekrete nuk u vendosen në dispozicion palëve të treta jashtë Bankës së Shqipërisë, edhe nëse janë plotësuar kushtet për deklarim sipas këtij ligji, nëse ky publikim do të binte ndesh me detyrimet dhe detyrat e Bankës së Shqipërisë sipas Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane dhe rregullave mbi konfidencialitetin e Bashkimit Evropian, ose nëse një publikim i tillë do të rrezikonte reputacionin ose interesat e Bankës Qendrore Evropiane ose të bankave qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare.

Neni 89

Mbledhja e të dhënave statistikore

1. Me qëllim ndjekjen e objektivave të saj dhe ushtrimin e detyrave ose funksioneve të saj, të specifikuar në këtë ligj, Banka e Shqipërisë merr pjesë në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore në përputhje me Nenin 5 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.
2. Në ushtrimin e veprimtarive të përmendura në pikën 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Bankën Qendrore Evropiane dhe institucione e organe të tjera të Bashkimit Evropian, organet kompetente të Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta, si dhe institucionet financiare ndërkombëtare.
3. Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë llojin e të dhënave statistikore, mënyrën se si do të dorëzohen të dhënat, modelet dhe metodat standarde për mbledhjen, përpunimin, shpërndarjen dhe përhapjen e të dhënave statistikore të përpunuara, personat përgjegjës për dorëzimin e të dhënave statistikore, si dhe masat e procedurat për ofrimin dhe mbrojtjen e të dhënave të konsideruara sekrete, në përputhje me ligjin.
4. Rregulloret dhe aktet e tjera të përmendura në pikën 3 të këtij neni duhet të jenë në përputhje të plotë me rregulloret dhe aktet e tjera të Bashkimit Evropian.

KREU XV

ANËTARËSIMI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË UNIONIN MONETAR EVROPIAN

Neni 90

Politika monetare brenda sistemit Euro

Nga data e prezantimit të EURO-s si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë do të kryejë detyrat e saj të politikës monetare në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e

Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe aktet e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 91

Emetimi dhe tërheqja e kartëmonedhave dhe monedhave Euro

1. Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë do të jetë “Euro”.
2. Banka e Shqipërisë do të fusë në qarkullim kartëmonedhat dhe monedhat Euro dhe do t'i tërheqë ato nga qarkullimi në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, aktet e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.
3. Banka e Shqipërisë përcakton dizajnin e monedhave që emeton në përputhje me rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian.

Neni 92

Rezervat e detyrueshme dhe instrumentet e tjera të politikës monetare

Banka e Shqipërisë zbaton rezerva të detyrueshme dhe instrumente të tjera të politikës monetare, në përputhje me aktet dhe udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 93

Transferimi dhe administrimi i rezervave valutore brenda sistemit Euro

Nga data e prezantimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë do të transferojë aktivet e rezervave valutore në Bankën Qendrore Evropiane dhe do të administrojë çdo rezervë valutore të mbetur në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe aktet e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 94

Rezervat valutore pas kalimit në EURO

Pas prezantimit të EURO-s si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë do të mbajë dhe administrojë rezervat valutore në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane,

si dhe aktet e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 95

Raportimi dhe zbatimi i akteve të Bankës Qendrore Evropiane

Banka e Shqipërisë raporton dhe bashkëpunon me Bankën Qendrore Evropiane dhe zbaton aktet, udhëzimet, instruksionet dhe vendimet e Bankës Qendrore Evropiane, në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 96

Mbledhja e të dhënave statistikore brenda sistemit Euro

Nga data e prezantimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë mbledh, përpilon dhe transmeton të dhëna statistikore të nevojshme për kryerjen e detyrave të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe sistemit Euro, në përputhje me aktet e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 97

Sistemet e pagesave brenda sistemit Euro

Nga data e prezantimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë do të kryejë detyrat e saj lidhur me sistemet e pagesave dhe operacionet e pagesave në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, si dhe aktet e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Neni 98

Konsultimi dhe zbatimi i opinioneve të Bankës Qendrore Evropiane

Kur projektligjet, rregulloret ose aktet e tjera ligjore janë brenda fushave të kompetencës së Bankës Qendrore Evropiane, autoritetet kompetente konsultohen me Bankën Qendrore Evropiane në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe aktet e Bashkimit Evropian. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet kompetente për të siguruar përmbushjen e këtij detyrimi.

Neni 99

Detyrimi i përgjithshëm për të respektuar aktet e Bankës Qendrore Evropiane

Nga data e prezantimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë duhet të respektojë dhe të zbatojë të gjitha aktet, vendimet, rregulloret, udhëzimet dhe instruksionet me karakter detyrues të Bankës Qendrore Evropiane dhe të Bashkimit Evropian që zbatohen për bankat qendrore kombëtare të Shteteve Anëtare, monedha e të cilave është Euro.

Neni 100

Detyrat dhe funksionet e Bankës së Shqipërisë brenda sistemit Euro

1. Banka e Shqipërisë, si pjesë e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në përputhje me Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, merr pjesë në përcaktimin dhe zbatimin e politikës monetare të Bashkimit Evropian, kryen operacione valutore në përputhje me nenin 219 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, mban dhe administron rezervat valutore që nuk janë transferuar te Banka Qendrore Evropiane, si dhe nxit funksionimin e rregullt të sistemeve të pagesave.
2. Përveç detyrave të përcaktuara në pikën 1, Banka e Shqipërisë ushtron edhe detyrat dhe funksionet e tjera që i ngarkohen nga ky ligj dhe nga ligje të tjera, duke përfshirë stabilitetin financiar, rregullimin, licencimin, mbikëqyrjen, ndërhyrjen e jashtëzakonshme, sistemet e pagesave, statistikën, funksionin e agjentit fiskal dhe veprimtari të tjera, në përputhje me Traktatin për Bashkimin Evropian, Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.
3. Kur dispozita të veçanta të këtij ligji nuk janë në përputhje me Traktatin për Bashkimin Evropian, Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian ose Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, dispozitat e Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane do të kenë përparësi dhe do të mbizotërojnë mbi parashikimet e këtij ligji.

Neni 101

Pjesëmarrja në institucionet monetare ndërkombëtare

Banka e Shqipërisë mund të marrë pjesë në veprimtarinë e institucioneve monetare ndërkombëtare vetëm me miratimin e Bankës Qendrore Evropiane, në përputhje me nenin 6.2 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 102

Instrumente të tjera të kontrollit monetar

Banka e Shqipërisë mund të zbatojë instrumente të tjera të kontrollit monetar në përputhje me kushtet dhe brenda limiteve të përcaktuara në nenin 20 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 103

Veprimtaritë e jashtme

1. Në përputhje me nenin 23 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë mund të krijojë marrëdhënie me bankat qendrore dhe institucionet financiare të vendeve të tjera dhe, sipas rastit, me institucionet ndërkombëtare; të blejë dhe të shesë, në mënyrë përfundimtare (me dorëzim të menjëhershëm ose në të ardhmen) të gjitha llojet e titujve dhe instrumenteve të tjerë të tregtueshëm dhe metaleve të çmuara; t'i mbajë dhe administrojë këto aktive; si dhe të kryejë të gjitha llojet e tjera të transaksioneve bankare në lidhje me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë operacionet e huamarrjes dhe të huadhënies.
2. Siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, aktivet në valutë përfshijnë tituj dhe aktive të tjera në çdo valutë të huaj ose njësi llogarie, pavarësisht formës në të cilën mbahen.

Neni 104

Nënshkrimi i kapitalit të Bankës Qendrore Evropiane

Banka e Shqipërisë nënshkruan dhe shlyen kapitalin e Bankës Qendrore Evropiane në përputhje me nenet 28 dhe 29 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 105

Transferimi i aktiveve të rezervës valutore te Banka Qendrore Evropiane

1. Banka e Shqipërisë transferon te Banka Qendrore Evropiane një pjesë të aktiveve të rezervës valutore në përputhje me nenin 30 të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.
2. Banka e Shqipërisë mund, nëse autorizohet për këtë qëllim nga Banka Qendrore Evropiane, të administrojë pjesën e transferuar të aktiveve të rezervës valutore të përmendura në pikën 1 të këtij neni, në emër dhe për llogari të Bankës Qendrore Evropiane, në përputhje me udhëzimet e saj.

Neni 106
Administrimi i aktiveve

1. Banka e Shqipërisë administron pjesën e aktiveve të rezervës valutore që nuk është transferuar te Banka Qendrore Evropiane, si dhe aktivet e tjera të regjistruara në bilancin e Bankës së Shqipërisë në datën e prezantimit të euros si monedhë e Republikës së Shqipërisë.
2. Banka e Shqipërisë administron aktivet e rezervës valutore të përmendura në pikën 1 të këtij neni në përputhje me udhëzimet e saj, duke respektuar parimet e likuiditetit dhe sigurisë.
3. Banka e Shqipërisë mund të kryejë transaksione në kuadër të administrimit të aktiveve të rezervës valutore të përmendura në pikën 1 të këtij neni, mbi kufirin e përcaktuar në udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe transaksione me gjendjet operative valutore të Republikës së Shqipërisë, mbi kufirin e përcaktuar në udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane, me miratimin paraprak të Bankës Qendrore Evropiane.
4. Pavarësisht përcaktimit të pikës 3 të këtij neni, transaksionet e kryera për përmbushjen e detyrimeve ndaj institucioneve ndërkombëtare nuk i nënshtrohen miratimit të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 107
Kompetencat e Këshillit brenda sistemit Euro

1. Këshilli miraton rregullore dhe akte të tjera ligjore për realizimin e objektivave dhe ushtrimin e detyrave dhe funksioneve të Bankës së Shqipërisë, bazuar në kompetencat e dhëna nga ky ligj, ligje të tjera, Statuti i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe i Bankës Qendrore Evropiane, si dhe aktet e tjera të Bashkimit Evropian.
2. Këshilli vendos për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në institucionet financiare ndërkombëtare dhe, kur kërkohet, në institucionet monetare ndërkombëtare, me miratimin e Bankës Qendrore Evropiane.
3. Këshilli miraton aktet që lidhen me pasqyrat financiare, raportet, tarifat, të drejtat dhe detyrimet në marrëdhëniet e punës, administrimin e aktiveve, si dhe çështje të tjera që bëjnë pjesë në kompetencën e tij sipas këtij ligji dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Neni 108
Anëtarësimi në Këshillin Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 109

Rezultati financiar dhe shpërndarja e fitimit

1. Rezultati financiar, fitimi ose humbja, i Bankës së Shqipërisë përcaktohet për çdo vit financiar si diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të saj.
2. Një pjesë e fitimit mund të alokohet në rezervën e përgjithshme dhe në rezervat e veçanta, në masën e përcaktuar nga Këshilli, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat kontabël të zbatueshme të Bankës Qendrore Evropiane.
3. Pjesa e mbetur e fitimit përbën të ardhur për Buxhetin e Shtetit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj, Statuti i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe i Bankës Qendrore Evropiane ose rregullat kontabël dhe udhëzimet e Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 110

Pasqyrat financiare dhe caktimi i audituesit

1. Banka e Shqipërisë harton dhe publikon pasqyrat financiare në përputhje me standardet, rregullat dhe udhëzimet e kontabilitetit të Bankës Qendrore Evropiane.
2. Në pasqyrat financiare vjetore të Bankës së Shqipërisë do të përfshihet një pjesë e të ardhurave monetare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane të shpenzuara gjatë zbatimit të politikës monetare të përbashkët, siç përcaktohet nga Banka Qendrore Evropiane në përputhje me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.
3. Auditimi i pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë kryhet nga një auditues i jashtëm i pavarur, i caktuar në përputhje me nenin 27, pika 1, të Statutit të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane.

Neni 111

Udhëzimet dhe sanksionet e Bankës Qendrore Evropiane

1. Në fushat që janë kompetencë e Bankës Qendrore Evropiane dhe që rregullohen me udhëzimet e saj, Banka e Shqipërisë mund të miratojë akte normative për zbatimin e tyre, me miratimin paraprak të Bankës Qendrore Evropiane kur kjo kërkohet.
2. Banka e Shqipërisë zbaton sistemin e sanksioneve të Bankës Qendrore Evropiane dhe merr pjesë në proceset e vendosjes së sanksioneve të Bankës Qendrore Evropiane në përputhje me rregulloret e Bankës Qendrore Evropiane dhe rregulloret e tjera të Bashkimit Evropian.
3. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë kundërvajtjet ose sanksionet administrative nuk zbatohen kur veprimet përkatëse i nënshtrohen sistemit të sanksioneve të Bankës Qendrore Evropiane.

Kreu XVI

Dispozitë kalimtare dhe përfundimtare

Neni 112

Dispozita kalimtare

Rritja fillestare e kapitalit të nënshkruar, deri në shumën prej 6 (gjashtë) miliardë lekësh, bëhet nga rezervat e posaçme të krijuara nga fitimet e Bankës së Shqipërisë. Nëse fondet e rezervës janë të pamjaftueshme për të mbuluar rritjen fillestare të kapitalit të nënshkruar të specifikuar më sipër, pjesa e mbetur e fondeve ofrohet nga Ministria e Financave.

Neni 113

Statusi i anëtarëve të Këshillit

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të emëruar sipas dispozitave të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin deri në përfundimin e mandatit të tyre.

Anëtarët e Këshillit të Bankës së Shqipërisë, të emëruar deri në ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, do të vazhdojnë të ushtrojnë funksionin deri në përfundimin e mandatit të tyre.

Anëtarët e Këshillit të Bankës së Shqipërisë, të emëruar deri në ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Unionin Monetar Evropian, do të vazhdojnë të kryejnë këtë funksion deri në përfundim të mandatit të tyre.

Neni 114

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Nga dita e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dispozitat e neneve 34, 35, 45 (2) të këtij ligji shfuqizohen.
3. Nga dita e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Unionin Monetar Evropian, nenet: 5, 6 (b), 6 (c), 6 (d), 10-12, 14-22, 37 (2/c), 37 (2/f), 37 (2/h), 38, 56 (3), 56 (5), 58 të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 115

Dispozita përfundimtare

1. Aktet normative të miratuara në zbatim të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbeten në fuqi dhe zbatohen si akte të miratuara sipas këtij ligji, deri në ndryshimin, zëvendësimin ose shfuqizimin e tyre.
2. Në rast mospërputhjeje midis dispozitave të akteve normative në fuqi dhe dispozitave të këtij ligji, ky ligj do të mbizotërojë.

Neni 116

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të sa më poshtë:

- a) Kreu XIV i këtij ligji hyn në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- b) Kreu XV i këtij ligji hyn në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Unionin Monetar Evropian.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI